



RAPORT 2024

Shërbimi Social Shtetëror

RAPORT

2024

Tiranë 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

	HYRJE.....	4
I.	DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK.....	5
II.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE.....	47
III.	DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PAK.....	59
IV.	DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS.....	65
V.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME.....	79

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2024. Raporti është i organizuar në formën e një raportimi të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2024.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet ndër vite duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REME XHOLI

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, funksionon në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë : Sektori i Kontrollit të NE dhe Sektori i Kontrollit PAK dhe zhvillon veprimtarinë në zbatim të Ligjit Nr.57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar, VKM-së Nr. 257, datë 05.05.2021 “ Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”, Shtojca Nr.1 “Metodologjia e Kontrollit të ndihmës ekonomike”, VKM-së Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës , të Kriteve, Proçedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e Aftësisë së Kufizuar të Ndihmës Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre” i ndryshuar, VKM-së Nr. 431, datë 08.06.2016 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Dokumentacionit, të Proçedurave, dhe të Masës së Përfitimit e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar e të Ndihmës Personal dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre në Zonat Pilot”, Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar ” si dhe Urdhërit Nr.462, datë 29.10.2021 “ Për Shtrirjen e Sistemit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar dhe Mekanizmin e Kontrollit dhe Monitorimit ”.

Ndihma ekonomike është një nga programet kryesore të mbrojtjes sociale për kategoritë në nevojë. Paga cash për familjet /individët në nevojë mbështetet me përfitime të tjera si çerdhe - kopësht falas, libra falas, bursë shkollimi për studentët e familjeve të NE-së kur ndjekin arsimin e lartë, vizitë mjekësore falas, shërbime rimbursim të ilaceve, punësim dhe formim profesional.

Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera me qëllim zbutjen e varfërisë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojnë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre si dhe individët :

- jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore,
- prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;
- viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

I.Zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike nëpërmjet kontrolleve të ushtruara pranë njësive vendore si dhe në bazë të Urdhërit të MSHMS Nr. 46, datë 30.01.2024, “Për krijimin e Task Forcës për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike”.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK/ 12 DR SHSSH kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2024 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës. Nëpërmjet kontrolleve vlerësohet performanca e strukturave rajonale të SHSSH për kryerjen e kontrolleve të NE-së në njësitë e vetqeverisjes vendore, cilësia e projekt/raporteve sipas

zbatimit të hapave të përcaktuara në metodologjinë e kontrollit, ndjekja e zbatimit të detyrave të lëna lidhur me shpërblimin e dëmit, raportimin 6 mujor pranë SHSSH si dhe analiza e riskut të kontrollit tematik në njësitë vendore. Plan i vitin 2024 nuk është realizuar pasi në muajin Shkurt, Drejtoritë Rajonale të SHSSH kanë vijuar punën me verifikimet në familje fillimisht duke nisur nga qarqet që mbartin riskun më të lartë, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë të cilat zënë 71% të familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike dhe duke vijuar në muajin Prill-Maj me 8 qarqet e tjera të cilat pëfaqësojnë 29 % të familjeve përfituese në, Durrës, Vlorë, Tiranë, Berat, Fier, Gjirokastrë, Lezhë dhe Shkodër.

Rastet e konstatuara të cilët kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin gjatë kontrolleve të ushtruara nga SHSSH të cilat kanë qenë me përzgjedhje (për shkak të burimeve të limituara njerëzore dhe mungesë infrastrukture) si dhe të iniciuara nga ankesat e qytetarëve, kanë rezultuar në papërgjegjshmëri të njërive vendore gjatë procedurave të aplikimit për përfitim. Përsa i përket verifikimit të situatës social-ekonomike në banesë nga administratorët shoqërorë të njësisë, konstatohet se:

- Mungojnë vizitat ose janë kryer me vonesë dhe jo brenda muajit të parë të aplikimit për hyrjet e reja dhe dy herë në vit për ato ekzistuese ashtu si ligji e parashikon. Kjo procedurë është shumë e rëndësishme për të verifikuar situatën reale të familjeve nëse ato janë realisht në kushtet e përfitimit të pagesës si familje në nevojë, por dhe shumë e rëndësishme në vendimmarrjen e Drejtorisë Rajonale bazuar në Ligjin 57/2019, “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 23, gërma c)...
- Administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse si dhe nuk përditësohen të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit. Në rastet kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja “po” ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me saktësi dhe korrektësi.
- Familje që trajtohen nga fondi deri në 6% pa përmbushur kriteret ligjore.
- Deklaratat 3-mujore nuk janë firmosur nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes

Pasqyrim i saktë i situatës social ekonomike të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike në vend, vlerësimi i skemës së NE me qëllim përmirësimin e saj, monitorim i mirëfilltë i punës së administratorëve shoqërorë dhe gjithë zinxhirit të institucioneve të ndërlidhura në reformën e NE-së në të gjithë vendin., ka qenë në focus të punës së SHSSH gjatë vitit 2024.

Për të bërë të mundur verifikimin social ekonomik të përfituesve të NE-së në gjithë vendin, u

ndërmor Urdhëri I MSHMS Nr. 46, datë 30.01.2024, “Për krijimin e Task Forcës për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike”, është ndërtuar metodologjia e punës së Task -Forcës .

Gjithsej kanë funksionuar 63 grupe pune për 12 qarqet

- 40 grupe pune /10 grupe pune çdo qark /në qarqet Dibër, Kukës, Korçë dhe Elbasan
- 23 grupe pune të DRSHSSH në 8 qarqet e tjera
- Eshtë përgatitur dhe ndjekur kalendarit i punës për çdo qark /planifikimi sipas vlerësimit të riskut
- Janë trajnuar grupet e punës /gjithsej 120 përfaqësues nga MSHMS, SHSSH, ISHSH dhe NJVKSH-të
- Janë hartuar dhe koordinuar materialet e vëna në dispozicion për task forcën / Plotësimi i akt konstatimit/Njoftimet kur nuk gjendet familja në banesë/Proces-Verbal në mometin kur anëtarët madhorë nuk gjenden në banesë dhe detyrimi për tu paraqitur në njësitet administrative

Sipas dinamikës së skemës së ndihmës ekonomike dhe riskut që paraqesin janë përzgjedhur për fillimin e task forcës fillimisht qarqet Elbasan, Korçë, Dibër dhe Kukës të cilët përfaqësojnë 71% të familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike.

Në këto qarqe grupet e punës kanë qenë të përbërë nga përfaqësuesit e SHSSH, NJVKSH dhe ISSH-së. Sipas kalendarit të miratuar verifikimet social ekonomike janë kryer nga muaji deri në maj.

Grupet e punës kanë qenë të koordinuara nga 4 koordinatorët e Drejtorisë së Përgjithshme e SHSSH / Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK/Spektori i NE-së.


Task Forca ka vijuar në 8 qarqet e tjera në muajt prill, maj dhe qershor në përbërje me stafet respektive të Drejtorive Rajonale të SHSSH duke patur parsysh që kanë një numër jo të lartë të përfituesve të NE-së.


Për periudhën shkurt – qershor 2024 në 12 qarqet , grupet e task forces **kanë verifikuar 91% e familjeve përfituese** duke kryer verifikim social ekonomik në banesë për **47.246 familje përfituese** nga Regjistri Elektronik i Ndihmës Ekonomike dhe të trajtuara me fondin deri në 6%.

Qarku	Nr. përfituesish sistem+6%	Nr. verifikimeve NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje që nuk u gjenden në banesë	Familje që nuk u gjenden në banesë dhe nuk janë paraqitur në njësinë administrative
Kukës	7931	7203	5379	143	1681	238
Gjrokastrë	864	698	560	26	112	43
Shkodër	4397	3510	3186	143	181	32
Dibër	9475	8962	6519	306	2137	1260
Vlorë	1476	1515	1312	20	183	36
Fier	1395	1114	956	41	117	38
Berat	1229	1146	897	24	225	11
Elbasan	11881	10925	8200	728	1997	937
Durrës	689	675	502	9	164	21
Tiranë	2468	2305	1643	96	566	2
Korçë	7386	7062	4624	456	1982	887
Lezhë	2584	2131	1659	22	450	58
TOTALI	51775	47246	35437	2014	9795	3563

Në nivel kombëtar janë kryer 47.246 verifikime në banesë ose 91% të familjeve përfituese nga Skema e Ndhmës Ekonomike. Nga verifikimet e kryera rezultoi:

- **35.437 familje ose 95%** janë konsideruar familje në nevojë, ku prej të cilave **7.711 ose 22%** janë konsideruar familje ekstremisht të varfra.
- **2.014 familje ose 5%** e familjeve përfituese nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike ku prej tyre janë refuzuar **786 familje nga skema e NE.**
- **3.563 familje ose 7.5 %** e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit, nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative.





Shënim: % e vlerësuar është në raport me numrin e përfituesve për secilin qark. Qarqet që kanë numër të vogël përfituesish kanë shtrirje të gjerë gjeografike.

1.Qarqet me numrin më të lartë të familjeve në kushte shumë të mira dhe që nuk ndodhen në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike në raport me numrin e përfituesve janë :

Qarku Korçë, 9% e familjeve nuk duhet të jenë përfitues, respektivisht Bashkia Pogradec ka rezultuar si bashkia me më shumë problematika dhe gjetje gjatë periudhës së task forcës. Bashkia Pogradec ka dhe numrin më të lartë të përfituesve në të gjithë qarkun, është një bashki që ka mundësi punësimi për shkak se është zonë kufitare, zonë turistike dhe zonë me toka bujqësore.

Qarku Elbasan, 8% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. Njësitë Rrajcë dhe Qukës të bashkisë Prrenjas, Gjocaj e bashkisë Peqin, Polis e bashkisë Librazhd, Shushicë të bashkisë Elbasan, janë njësitë me numrin më të lartë të familjeve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara.

Qarku Dibër, 5% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. Njësitë me riskun më të lartë bazuar edhe në gjetjet e konstatuara janë, Njësia Maqellarë, Kastriot dhe Tomin që i përkasin Bashkisë Dibër dhe njësia Gjoricë e Bashkisë Bulqizë, të cilat zënë rreth 30% të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike në Qarkun Dibër.

Qarku Dibër ka numrin më të lartë të familjeve të verifikuara të cilat janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike (në vështirësi ekonomike) por nuk u gjend të paktën një anëtar madhor present me arsye të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale me periudha 1-3 mujore.

Masat e marra për familjet të cilat kanë kushte shumë të mira jetese dhe nuk janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe nuk janë gjendur në banesë.

➤ *Nga 2014 familje të evidentuara në kushte shumë të mira jetese dhe nuk janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, 786 familje janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike. Për familjet e tjera është duke u vijuar me procedurat në zbatim të legjislacionit.*

➤ *Për 3563 familje të cilat nuk u gjendën në banesë dhe nuk u paraqitën në njësitë administrative për të firmosur procesverbalin, është dërguar lista për verifikim pranë Ministrisë së Brendshme për hyrje /daljet për periudhën janar-qershor 2024, për të cilat do të vijohet me procedurën pas këtij verifikimi.*

➤ *Njësitë të cilat kanë patur riskun më të lartë gjatë task forcës do të jenë subjekt i kontrollit nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shetëror për periudhën korrik-dhjetor 2024.*

Evidentime / konstatime

- Në familjet e verifikuara të cilat janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike (në vështirësi ekonomike) por nuk u gjend të paktën një anëtar madhor present me arsye të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale me periudha 1-3 mujore.
- Në njësitë afër zonave kufitare, shumë prej anëtarëve të familjeve në skemën e NE punojnë jashtë shtetit dhe nuk i deklarojnë të ardhurat nga puna informale dhe nga emigracioni.
- Fenomen i konstatuar gjatë verifikimeve në banesë lidhet me ndarjet nga trugu familjar të anëtarëve në moshë aktive por banojnë në të njëjtën strehë, dhe banesa apo mjetet motorike i kalojnë në pronësi të prindërve për efekt përfitimi.
- Familjet në nevojë në qarkun e Tiranës krahasuar me qarqet e tjera kanë qenë familje pa të ardhura dhe në kushte shumë të vështira jetese/në banesa të papërshtatshme/banesa sociale.
- Verifikimet social ekonomike të kryera nga administratorët shoqërorë dhe deklarimet 3 mujore të hedhura në Regjistrin Elektronik të Ndihmës Ekonomike bëhen fiktive, duke sjellë abuzime në skemën e ndihmës ekonomike, në kundërshtim me ligjin 57/2019 “Për Asistencën Sociale në RSH”.
- Gjendja e pasqyruar në formularët e aplikimit nga administratorët shoqëror, nuk përkon me gjendjen reale social ekonomike të familjeve, pra plotësimi i formularëve nuk është i saktë.
- Zonat më të varfra rezultojnë njësitë e qytetit, ku familjet përfituese kryesisht janë pa të ardhura, ndryshe nga zonat rurale që kanë të ardhura nga bujqësia/blegtoaria.

- Numri i punonjësve të NE kryesisht në njësitë qendër është i lartë krahasuar në njësitë rurale, ndonëse numri i përfituesve në këto njësi është më i lartë, (problematikë që rrjedh nga organizimi i strukturës në qeverisjen vendore).

II.2. Gjetjet nga Task Forca lidhur me moszbatimin e legjislacionit nga njësitë vendore gjatë aplikimit dhe përfitimin për ndihmën ekonomike:

Familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, me kushte shumë të mira social ekonomike apo familje jo prezente pranë njësive përkatëse ka ardhur si pasojë e mosnjohjes plotësisht të legjislacionit të NE-së dhe procedurave të sakta që duhet të ndiqen, nisur nga formulari i aplikimit i kyer nga administratorët shoqërorë ku dhe në vijimësi ka shkaktuar përfitime të padrejta në skemën e ndihmës ekonomike që lidhen me:

- Verifikimet social ekonomike në njësitë problematike të përmendura të kryera nga administratorët shoqërorë dhe deklaratimet 3 mujore të hedhura në Regjistrin Elektronik të Ndihmës Ekonomike, nuk janë kryer sipas procedurave ligjore pasi gjendja e pasqyruar në formularët e aplikimit nga administratorët shoqërorë nuk përkon me gjendjen reale social ekonomike të familjeve përfituese, duke sjellë abuzime në skemën e ndihmës ekonomike, në kundërshtim me ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në RSH”;
- Mosdeklarim të të ardhurave nga puna informale/puna sezonale//migrimi/emigrimi nga familjet sidomos në njësitë pranë zonave kufitare.
- Familjet të cilat jetojnë në zonat rurale dhe kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore dhe blegtori nuk i deklarojnë të ardhurat që sigurojnë
- Mosprezenca e anëtarëve madhorë në familjet e verifikuara, familje në vështirësi ekonomike
- Ndarje nga trangu familjar të anëtarëve madhorë për arsye të ndryshme përfitimi dhe familjet vijnë të jetojnë në një strehë të përbashkët;
- Evidentimi i një numri të konsiderueshëm të anëtarëve në moshë aktive pune (18-55 vjeç) të cilët nuk rezultojnë të regjistruar pranë zyrave të punës
- Përfitimet e tjera që lidhen me përjashtimin nga pagesave e tarifave Shkollore dhe bursa për studentët është një nga faktorët që familje të cilat kanë një burim të ardhurash të aplikojnë për të përfituar NE.

II.3. Lidhur me gjetjet nga task-forca, për 12 qarqet është hartuar plani i masave për periudhën Shtator-Dhjetor 2024 si dhe janë udhëzuar për procedurën që do të ndiqet: 1.Verifikimi në banesë i familjeve të cilat nuk janë gjendur gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës në 12 Qarqet,

- a- Evidentimi i njësive me riskun më të lartë / Plani i Punës periudha Shtator- Dhjetor 2024
- b- Gjenerimi nga sistemi i listës emërore të familjeve që kanë deklaratimin 3-mujor sipas muajve

- c- Prezenca fizike e punonjësve të DR nga data 1 deri në datën 10 e muajit të shpërndarë në njësitë e riskuara sipas planit të punës
- d- Mbajtja e akt-konstatimit (Proces-Verbal) në njësi midis administratorit shoqërorë dhe specialistit të DR për ato familje të cilat nuk paraqiten për të firmosur
- e- Për familjet me anëtarë madhorë jo prezent do të vijohet e njëjta procedurë, mbajtja e akt-konstatimit (Proces-Verbal) në njësi midis administratorit shoqërorë dhe specialistit të DR. Rakoordimi me Akt-Konstatimet, periudha Shkurt-Maj, lidhur me familjet që nuk janë gjendur në banesë (përshkrimi i kryer, psh; familje që jetojnë jashtë shtetit, banesa në dukje nga jashtë në gjendje shumë të mire,), për këto familje **do të kryhet vizita nga administatori shoqëror dhe nëse familja do të vlerësohet në kushtet e përfitimit/jo përfitimit, do të vijohet me hedhjen në sistem të vizitës së kryer dhe më pas DR do të vijojë me procedurën sipas Legjislacionit të NE-së.**

2. Familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë

- a- Verifikimi në sistem i statusit aktual të familjes, përfitues ose refuzuar
- b- Refuzimi nga skema e NE-së i familjeve të cilat rezultojnë ende përfituese

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra, mbështetje nga programet e mbrojtjes sociale, pako ushqimore etj.

- a- Hartimi i planit të masave nga DR në koordinim me Bashkitë përkatëse
- b- Raport mujor lidhur me rastet e menaxhuara
 - Mbështetje me paketa ushqimore/mjete shkollore/veshmbathje (marrëveshje me organizata/shoqata)
 - Anëtarë të orientuar për të përfituar PAK
 - Shërbime të tjera (Bonus qiraje, restaurime, trajtim me fondet e Bashkive etj)
- c- Referimi me prioritet i anëtarëve në moshë aktive pune tek AKPA (ndjekja e listës të anëtarëve nga DR)
 - Orientim për punësim/formim profesional
 - Ndërmarrje Sociale

4. Verifikimi në banesë i familjeve në muajin e parë të aplikimit përpara procesit të pikëzimit.

- a- DR SHSSH sipas planit të punës për njësitë me risk, në bashkëpunim me administratorin, do të kryejnë vizitën në banesë për familjet që aplikojnë për herë të parë.

5. Kontroll fizik dhe Monitorim nga DKP NE & PAK në Qarqet me riskun më të lartë lidhur me zbatimin e Planit të Masave për periudhën Shtator-Dhjetor 2024

II.3. Masat që janë ndërmarrë në zbatim të rekomandimeve të lëna:

Raporti nga Task forca Korrik-Dhjetor 2024								
Qarku	Familje ne gjendje shume te mire	Refuzuar	Familje ende përfituese	Familje jo prezente	Refuzuar	Familje ende përfituese	Familje ekstremisht te varfra	Ndimuar, paketa ushqimore, banesa sociale, bonus qiraje, restaurime banese etje..
Elbasan	728	605	123	937	448	489	1539	330
Dibër	306	118	188	1260	389	871	1769	94
Kukës	143	94	49	238	101	137	965	663
Korçë	456	352	104	887	317	570	915	168
Shkodër	143	44	99	32	12	20	661	171
Tiranë	96	94	2	2	2	0	408	3910
Lezhë	22	18	4	58	50	8	426	947
Fier	41	41	0	38	23	15	298	43
Vlorë	20	19	1	36	34	2	359	130
Berat	24	19	5	11	5	6	266	0
Durrës	9	9	0	21	18	3	47	7
Gjirokastrë	26	14	12	43	17	26	102	337
Totali	2014	1427	587	3563	1416	2147	7755	6800

- *Për 2014 familje të evidentuara në kushte shumë të mira jetese dhe që nuk ndodheshin në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, 1427 familje ose 70% e familjeve nuk janë më përfituese në zbatim të legjislacionit të NE-së ndërsa 587 familje janë në proces rivlerësimi nga Drejtoritë Rajonale.*
- *Për 3563 familje të cilat nuk u gjendën në banesë dhe nuk u paraqitën në njësitë administrative për të firmosur, janë larguar nga skema 1416 familje ose 40% e familjeve dhe 2147 familje kanë qenë në proces monitorimi nga Drejtoritë Rajonale gjatë kontrolleve tematike në njësitë vendore lidhur me monitorimin e deklaratave 3-mujore për periudhën shtator-dhjetor 2024..*
- *Për 7755 familje të evidentuara në kushte shumë të vështira jetese, nga ana e Drejtorive Rajonale në 12 Qarqe në bashkëpunim me Bashkitë dhe shoqatat, të mbështesin këto familje. Në total janë ndihmuar 6800 familje me paketa ushqimore, trajtuar me bonus strehimi, mbështetje monetare, banesa sociale, restaurim banese, karroca për anëtarë PAK, këshillime Juridike dhe shërbime në banesa, mjete shkollore etj.*

Konstatime

- Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, vihet re se në qarqet Dibër dhe Shkodër vijojnë të jenë përfituese familjet e konstatuara në kushte të mira, në qarkun Dibër 61% e familjeve dhe Shkodër 70% e familjeve.
- Për familjet jo prezente gjatë verifikimeve, vijojnë të jenë ende në proces rivlerësimi një numër i lartë në qarqet Dibër me 70% të familjeve , Korçë 64% dhe Kukës 58%.
- Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra, qarqet që kanë mbështetur më së shumti këto kategori janë qarqet Tiranë, Lezhë, Kukës dhe Gjirokastrë.

II.4. Problematikat e konstatuara në zbatim të planit të masave për periudhën Korrik-Dhjetor 2024 mbi gjetjet e Task-Forcës.

- Riaplikim i familjeve të konstatuara në kushte shumë të mira duke mos respektuar afatin ligjor të penalizimit 6-mujor dhe 1- vjeçar nga ana e administratorit shoqëror për familjet e refuzuara nga skema e ndihmës ekonomike, në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Mosparaqitja e të gjithë anëtarëve madhorë gjatë deklaramit 3-mujor
- Mungesë e theksuar në përditësimin e të dhënave në formularët e aplikimit nga administratorët shoqërorë
- Familje që trajtohen nga fondi deri në 6% pa përmbushur kriteret ligjore
- Moskryerja e verifikimit social ekonomik nga adminstaratorët shoqëror për familjet aplikuese për herë të parë

REKOMANDIME

- Fuqizim i rolit dhe statusit të SHSSH-së, duke ndryshuar bazën ligjore për të vendosur sanksione administrative, jo vetëm të propozojë me qëllim për të ulur abuzivitetin në skemën e NE-së.
- Rritje e burimeve kapitale dhe njerëzore për Shërbimin Social Shtetëror për monitorimin dhe kontrollin e skemave të mbrojtjes sociale.
- Të rishikohet roli i administratorëve shoqërorë që të kenë varësi të dyfishtë nga SHSSH dhe njësitë vendore (të shikohet modeli i AKSHI-t) për një efikasitet të menaxhimit të politikave sociale.
- DRSHSSH të ushtrojnë kontrole tematike/prezencë fizike në njësitë administrative me risk të lartë gjatë periudhës së kryerjes së deklarimeve 3 mujore.
- Verifikimi automatik i familjeve përfituese te NE-së me sistemin TIMS, si instrument i rëndësishëm për të verifikuar lëvizjet e anëtarëve të familjes.
- Verifikimi automatik i Regjistrat Elektronik të NE-së me database e Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për verifikimin e pronësisë së banesave /tokës .
- Rishikimi i vlerësimit dhe pranueshmërisë së familjeve në skemë, duke marrë në konsideratë të ardhurat, pasi skema e NE-së ka si kriter jo vetëm familjet pa të ardhura por dhe me të ardhura të pamjaftueshme. Duhet të gjendet një mekanizëm për të

mbështetur familjet të cilat jetojnë në varfëri ekstreme dhe të ketë një masë të diferencuar për këto familje.

- Gratë kryefamiljare me fëmijë të mitur të jenë si kategori përfituese dhe të mos jenë në vlerësimin e formulës së pikëzuar.
 - Rritja e kapaciteteve në burime njerëzore për njësitë vendore dhe rishikimi i raportit administrator shoqërorë në përputhje me numrin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në çdo njësi.
 - Ndryshime në ligjin Nr.57 "Për Asistencën Sociale në RSH",
- a) Regjistrimi si punëkërkues të papunë i anëtarëve në moshë active pune dhe vijimi i procedurave për mundësinë e punësimit para se familja të aplikojë për përfitimin e ndihmës ekonomike.
- b) Regjistrimi si punëkërkues të papunë i anëtarëve në moshë madhore të familjeve përfituese të NE-së të cilët jetojnë në zonat rurale (**në afërsi të qendrave të banuara**) dhe kanë tokë.
- c) Në rastet kur familjet përfituese kanë anëtarë madhorë jashtë shtetit (emigracion/punë sezonale) apo kryejnë ndarje të anëtarëve nga trugu familjar **dhe ndodhen në kushte të vështira social ekonomike**, të mos penalizohet familja nga përfitimi por të procedohet zbritja e masës së përfitimit për anëtarin madhorë që ndodhet jashtë territorit të RSH apo kryen ndarje nga trugu familjar.

III. Analiza e detajuar e Task-Forcës në 12 Qarqe

Qarku Elbasan

Referuar Urdhërit të MSHMS Nr. 46, datë 30.01.2024, "Për krijimin e Task Forcës për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike", në qarkun Elbasan për periudhën Shkurt – Maj 2024 janë kryer gjithsej **10.925 verifikime në banesë të familjeve përfituese ose 92% të familjeve përfituese nga Skema e Ndhmës Ekonomike.**

Tabela përmbledhëse Shkurt - Maj 2024 Elbasan							
Qarku	Bashkia	Njësia	Nr. i verifikimeve NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje që nuk u gjenden në banesë	Familje me anëtarë madhorë jo prezent
ELBASAN	Librazhd	Qendër Librazhd	586	446	37	103	163
		Hotolisht	409	327	13	69	114
		Polis	264	196	21	47	50
		Librazhd	147	85	1	61	32
		Orenjë	75	64	4	7	36
		Lunik	222	215	1	6	1
	Elbasan	Steblevë	50	50	0	0	0
		Tregan	262	203	8	51	64
		Shirgjan	230	159	21	50	64
		Bradashesh	93	67	3	23	33
		Gjergjan	197	128	21	48	57
		Elbasan	987	714	4	269	204
		Labinot Fushë	244	194	2	48	49
		Papër	93	56	9	28	30
		Shushicë	242	152	44	46	85
		Gjinat	247	212	0	35	62
		Labinot Mal	487	416	10	61	7
		Funarë	216	211	3	2	6
		Gracen	138	92	7	39	0
		Zavalinë	98	93	0	5	0
		Gjocaj	241	134	33	74	64
		Përparim	201	118	18	65	58
	Peqin	Peqin	153	85	2	66	52
		Shezë	149	126	4	19	67
		Pajovë	151	96	11	44	64
		Karinë	107	104	0	3	0
		Kajan	152	94	17	41	38
	Belsh	Fierzë	54	43	3	8	23
		Belsh	149	106	4	39	43
		Rrasë	53	52	0	1	19
		Grekan	101	55	18	29	37
	Cërrik	Cërrik	217	142	0	75	41
		Gostimë	153	87	1	65	45
		Mollas	106	70	0	36	36
		Klos	93	66	9	18	39
		Shalës	45	33	0	12	20
	Gramsh	Gramsh	189	101	2	86	53
		Pishaj	265	229	1	35	63
		Kodovjat	195	169	1	25	105
		Kushovë	82	80	0	2	0
		Sult	73	72	0	1	0
		Tunjë	171	171	0	0	0
		Poroçan	171	171	0	0	0
		Lenie	89	88	0	1	0
		Kukur	234	234	0	0	0
		Skënderbegas	150	150	0	0	0
	Prrenjas	Qukës	640	449	110	81	293
		Rrajcë	771	441	243	86	347
		Stravaj	200	160	8	32	87
		Prrenjas	283	194	34	55	122
	7 Bashki	50 Njësi	10925	8200	728	1997	2773

- **8200 familje ose 92% e familjeve** të verifikuara janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat **1539 familje ose 19% janë familje ekstremisht të varfra**. Bashkitë Gramsh dhe Librazhd kanë rezultuar me numrin më të lartë të familjeve në kushte ekstremisht të varfra, me rreth 30% të familjeve përfituese.
- **728 familje ose 8 % e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike**, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruar si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. Njësitë Rrajcë dhe Qukës të bashkisë Prrenjas, Grekan dhe Kajan të bashkisë Belsh, Gjocaj e bashkisë Peqin, Polis e bashkisë Librazhd dhe Shushicë e bashkisë Elbasan, janë njësitë me numrin më të lartë të familjeve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara.

- **Për 2773 familje ose 34% e familjeve** të verifikuara që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale.
- **Nga 1997 familje** përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur present në banesë në momentin e verifikimit rezultoi se, **937 familje nuk janë paraqitur për të firmosur** pranë njësisë administrative.

Bashkitë me risk më të lartë dhe me më shumë problematika rezultuan Bashkia Prrenjas (njësitë Rrajcë dhe Qukës) ku 23% e familjeve përfituese në këtë bashki nuk plotësonin kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike, **Bashkia Belsh(njësitë Grekan dhe Kajan) ku 11% e familjeve** përfituese në këtë bashki nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike dhe **Bashkia Peqin (njësia Gjocaj) ku 9% e familjeve** përfituese në këtë bashki nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Elbasan ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratat tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 937 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezulton se, për periudhën Korrik - Dhjetor janë refuzuar në **total 448 familje** dhe 489 familje vijnë të jenë përfituese në skemë (process rivlerësimi).)

2. Për 728 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Shkurt- Dhjetor janë refuzuar **613 familje** nga të cilat 12 familje janë rivlerësuar dhe kanë riaplikuar në skemë si dhe 115 familje vijnë të jenë përfituese, 26 prej të cilave janë rivlerësuar se duhet të qëndrojnë në skemë me dokumentacionin përkatës.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë ndihmuar 276 familje me paketa ushqimore, për 2 familje është ofruar ushqimi i përditshëm, për 5 familje është ofruar restaurim banese, 2 familje janë pajisur me karrige me rrota, 34 familje janë mbështetur me bonus qiraje, 1 familje mbështetur me orendi shtëpiake dhe 10 familje janë mbështetur me ndihmë juridike falas.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 13 kontrole në njësitë Rrajcë dhe Qukës bashkia Prrenjas, njësitë Qendër Librazhd, Hotolisht dhe Polis të bashkisë Librazhd, Njësitë Grekan dhe Belsh të bashkisë Belsh, Njësia Gjocaj e bashkisë Peqin, Njësia Gostimë e bashkisë Cërrik, Njësitë Tregan, Gjergjan, Shirgjan dhe Shushicë të bashkisë Elbasan. Në total janë kryer 815 deklaratime 3 mujore nga të cilat rezulton se për 84 familje nuk janë gjeneruar deklaratat 3 mujore për arsye se nuk janë paraqitur anëtarët madhor për deklaram

Qarku Dibër

Në qarkun Dibër për periudhën Shkurt-Maj janë kryer gjithsej 8962 verifikime në banesë ose 95% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

Tabela përmbledhëse Shkurt-Maj 2024 Qarku Dibër							
Qarku	Bashki	Njësia	Nr.verifikimi NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje që nuk u gjendën në banesë	Familje me anëtarë madhorë jo prezent
Dibër	Dibër	Maqellarë	1146	713	169	264	450
		Kastriot	746	434	57	255	339
		Tomën	596	439	15	142	331
		Melan	394	260	9	125	173
		Dibër	378	216	7	155	151
		Sillovë	227	144	2	81	101
		Fushë-Çidhen	264	202	6	56	130
		Arras	161	119	2	40	66
		Kala e Dodës	99	82		17	51
		Lurë	37	30		7	1
		Muhurr	143	90		53	60
		Luzni	252	191	2	59	125
		Selishtë	143	137		6	
		Zall-Dardhë	104	104			
		Zall-Reç	82	82			
		total 15 njësi	4772	3243	269	1260	1978
	Bulqizë	Gjoricë	314	238	13	63	166
		Ostren	291	238	1	52	145
		Shupenzë	417	303	6	108	223
		Bulqizë	209	121		88	69
		Fushë-Bulqizë	121	68	1	52	41
		Zerqan	152	104	1	47	43
		Martanesh	47	47			
		Trebisht	94	78		16	36
		total 8 njësi	1645	1197	22	426	723
	Mat	Lis	109	76	1	32	45
		Komsi	195	151		44	76
		Ulëz	62	46		16	10
		Bazë	171	123		48	22
		Rukaj	161	159	2		
		Macukull	85	85			
		Burrel	338	334	4		
		Derjan	76	76			
		total 8 njësi	1197	1050	7	140	153
	Klos	Suç	214	143		71	100
		Gurrë	366	260	1	105	126
		Klos	564	422	7	135	184
		Xibër	204	204			
		total 4 njësi	1348	1029	8	311	410
	Total	35 njësi	8962	6519	306	2137	3264

- **6.519 familje ose 95% e familjeve të verifikuara janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat 1769 familje ose 20% janë familje ekstremisht të varfra.**
- **306 familje ose 5% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike referuar kushteve në të cilat jetojnë, prej të cilave 55 familje janë refuzuar gjatë periudhës së task-forcës Shkurt-Maj ndërsa *251 familje vijojnë të jenë përfituese.***
- **3.264 familje ose 50% e familjeve të verifikuara, të cilat konsiderohen familje në nevojë, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët si shëndetësore, punë sezonale brenda dhe jasht vendit.**
- Nga 2.137 familje përfituese të ndihmës ekonomike nuk janë gjendur present në banesë në momentin e verifikimit, ***1.260 familje e familjeve nuk janë paraqitur për të firmosur asnjë prej anëtarëve madhorë.***

Bashkitë që kanë rezultuar me risk të lartë janë Bashkia Dibër dhe Bulqizë duke pasur një numër të lartë të familjeve që nuk duhet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike për shkak se, janë zona kufitare dhe krijojnë të ardhura(të cilat nuk i deklarojnë), janë zona që kanë infrastrukturë dhe mundësi punësimi, zona ku tokat janë të punueshme/shfrytëzueshme si dhe familje të cilat nuk banojnë aty gjatë gjithë vitit por kthehen me sezone apo anëtarë që migrojnë/emigrojnë me periudha 1-3 mujore. Konkretnisht **njësitë Maqellarë, Kastriot dhe Tomin që i përkasin Bashkisë Dibër dhe njësitë **Gjoricë dhe Shupenzë të Bashkisë Bulqizë**, të cilat zënë mbi 30% të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike në Qarkun Dibër.**

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Dibër ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratimet tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 1260 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezulton se, për periudhën Korrik - Dhjetor janë refuzuar në **total 389 familje** dhe 864 familje vijojnë të jenë përfituese në skemë (process rivlerësimi).

2. Për 306 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Shkurt- Dhjetor janë refuzuar **118 familje** dhe 186 familje vijojnë të jenë përfituese.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë ndihmuar 40 familje me paketa ushqimore, janë shpërndarë 30 pako me mjete shkollore si dhe për 1 familje është mundësuar përfitimi i bonusit të qirasë.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 8 kontrolle në njësitë Peshkopi, Maqellarë, Kastriot, Tomin, Shupenzë, Gjoricë, Fushë Cidhen dhe Melan. Në total kanë pasur deklarinimin 3-mujor 1651 familje nga të cilat 1612 familje janë paraqitur dhe kanë firmosur pranë njësive administrative ndërsa 39 familje rezulton se nuk janë gjeneruar deklaratat 3 mujore për arsye se nuk janë paraqitur anëtarët madhor për deklarinim.

Qarku Kukës

Në qarkun Kukës për periudhën Shkurt-Maj janë kryer gjithsej 7203 verifikime në banesë ose 91% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

TABELA PËRMBLEDHËSE, QARKU KUKËS							
Qarku	Bashkia	Njësia	Nr. verifikimeve NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje që nuk u gjenden në banesë	Familje me anëtarë madhorë jo prezent Familje në nevojë
KUKËS	Kukës	Qytet Kukës	1043	691	31	321	192
		Bicaj	655	543	7	105	82
		Shtiqën	321	265	8	48	43
		Kolsh	136	119	2	15	13
		Tërthorë	288	204	7	77	86
		Shishtavec	282	214	1	67	66
		TopoJan	163	137	0	26	15
		Malzi	290	195	0	95	38
		Bushticë	70	63	0	7	7
		Kalis	48	46	0	2	0
		Surroj	135	105	0	30	29
		Ujmisht	294	224	0	70	30
		Arrën	63	53	0	10	6
		Grykë-Çajë	124	111	0	13	7
	Zapod	239	205	0	34	17	
	Has	Krumë	562	260	38	264	90
		Golaj	668	475	32	161	142
		Fajza	280	214	4	62	41
		Gjinaj	141	118	0	23	26
	Tropojë	Tropojë Fshat	408	324	9	75	133
		Llugaj	142	117	4	21	34
		Bajram Curr	170	151	0	19	5
		Bujan	165	136	0	29	21
		Fierzë	146	120	0	26	19
		Margegaj	166	130	0	36	28
		Lekbibaj	89	77	0	12	6
		Bytyç	115	82	0	33	10
TOTALI		7203	5379	143	1681	1186	

- **5379 familje ose 97% e familjeve të verifikuara** janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat **965 familje ose 18% janë familje ekstremisht të varfra.**
- **143 familje ose 3% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të Skemës së Ndhmës Ekonomike,** pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. **Prej tyre janë refuzuar 16 familje nga Skema e Ndhmës Ekonomike.**
- **1681 familje ose 23% e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike** nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit, nga të cilat **238 familje ose 4% e familjeve të verifikuara,** nuk janë gjendur në banesë dhe nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative.
- **Në 1186 familje ose 22% e familjeve të verifikuara** që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale.

Bashkia me riskun më të lartë dhe me më shumë problematika në qarkun Kukës rezulton Bashkia Has. Në këtë Bashki është konstatuar përqindja më e lartë e familjeve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike, për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara, kryesisht si pasojë e emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar, punës informale në Republikën e Kosovës, apo remitancave të cilat nuk deklarohen prej familjeve përfituese. **Në Bashkinë Has,** njësitet me riskun më të lartë janë **njësia Krumë dhe njësia Golaj.** 4% e familjeve përfituese në këtë Bashki nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike. Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Kukës ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë Task-Forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitet me riskun më të lartë **kryesisht me deklarimet tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 238 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer dhe

anëtarët madhorë të familjes nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative për të firmosur, rezulton se, për periudhën Korrik - Dhjetor janë refuzuar në **total 101 familje** dhe 137 familje vijojnë të jenë përfituese në skemë.

2. Për 143 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Shkurt- Dhjetor janë refuzuar **94 familje** dhe 49 familje vijojnë të jenë përfituese.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë ndihmuar 500 familje me pako ushqimore si dhe për 163 familje është mundësuar përfitimi i bonusit të qirasë.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 5 kontrolle në njësitë Krumë, Golaj, Shtiqën, Shishtavec dhe qytet Kukës. Gjatë periudhës Shtator- Dhjetor 2024 janë refuzuar me arsyen mosparaqitje për deklaratë 3 mujore 43 familje.

Qarku Korçë

Në Qarkun Korçë janë verifikuar në total 7062 familje ose 96% e familjeve përfituese, 1982 ose 28% familje nuk u gjendën në banesë në momentin e verifikimit, ku 887 ose 45% prej tyre nuk janë paraqitur në njësi për të firmosur. Rezultuan 4630 ose 91% familje të konsideruara si familje në nevojë, ku prej të cilave 915 ose 13% janë konsideruar familje ekstremisht të varfra, ndërsa 456 familje ose 9% si familje që nuk duhet të jenë pjesë e skemës së NE, ku prej tyre janë refuzuar 166 familje nga skema e NE.

Qarku	Bashkia	Njësia	NR.perfi tues NE+6%	NR.verifiki meve të kryera	Familje në nevojë	Familje me kushte shumë të mira	Familje që nuk janë gjendur në banesë	Familje në nevojë me anëtarë jo prezent
Korçë	Pogradec	Bucimas	760	758	469	85	204	99
		Çërravë	732	724	531	40	153	116
		Pogradec	456	444	239	11	194	50
		Udenisht	495	476	333	41	102	54
	Maliq	Pojan	511	505	313	13	179	58
		Libonik	486	448	257	41	150	75
		Gorë	94	94	91	3	0	28
		Vreshtas	514	478	339	26	113	69
		Moglicë	76	76	76	0	0	11
		Pirg	431	351	217	23	111	31
		Maliq	137	128	65	1	62	16
		Korçë	322	281	173	0	108	16
	Devoll	Bilisht	134	97	38	10	49	7
		Hocisht	253	217	122	31	64	14
		Miras	307	248	138	23	87	33
		Proger	146	93	48	18	27	13
		Q. Bilisht	222	175	91	12	72	17
	Kolonjë	Ersekë	54	42	25	2	15	5
		Q. Ersekë	67	33	15	0	18	2
	Korçë	Voskop	59	56	45	0	11	5
		Mollaj	70	32	17	2	13	1
		Lekas	14	14	14	0	0	0
		Vithkuq	37	36	36	0	0	0
		Voskopojë	26	22	22	0	0	1
		Q. Bulgarec	67	59	31	2	26	16
	Pogradec	Dardhas	250	247	131	20	96	23
		Proptisht	474	347	240	32	75	86
		Trebinjë	219	140	122	15	3	12
		Velçan	226	224	216	4	4	36
	Kolonjë	Barmash	14	11	11	0	0	1
		Leskovik	35	33	33	0	0	5
		Çlirim	7	7	7	0	0	0
		Novoselë	19	17	17	0	0	0
		Mollas	57	39	36	0	3	8
	Korçë	Drenove	63	50	32	1	17	7
	Pustec	Pustec	63	60	34	0	26	8
Korçë	6 Bashki	36 njësi	7897	7062	4624	456	1982	923

- **4624 familje ose 91%** të konsideruara si familje në nevojë, ku prej të cilave 915 ose 13% janë konsideruar familje ekstremisht të varfra Njesitë Gorë, Moglicë të bashkisë Maliq, Njesitë Trebinjë , Proptisht, Velçan të bashkisë Pogradec dhe bashkia Pustec.
- **456 familje ose 9%** e familjeve përfituese nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike ku prej tyre janë refuzuar **166 familje nga skema e NE.**
- **887 familje** të verifikuara që nuk janë gjendur në banesë dhe nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative.
- **Në 923 familje ose 20%** e familjeve të verifikuara që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët e tyre si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale

Bashkitë me risk më të lartë dhe me më shumë problematika rezultuan Bashkia Pogradec, Bashkia Maliq dhe Bashkia Devoll. Duke pasur parasysh terrenin kryesisht fushor është e zhvilluar bujqësia dhe blegtoaria por nuk deklarohen të ardhurat nga familjet në skemën e NE. Gjithashtu si zona kufitare, shumë prej anëtarëve të familjeve në skemën e NE punojnë jashtë shtetit dhe nuk i deklarojnë të ardhurat nga puna informale dhe nga emigracioni, duke ndikuar në kryerjen e veprimeve të qëllimshme (ndarje nga trangu familjar në të njëjtën strehë).

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Korçë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontroleve tematike në njësitë me riskun më të lartë kryesisht me deklarimet tre mujore për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, njësitë të cilat kanë pasur numër të konsiderueshëm të familjeve në gjendje shumë të mirë.

Nga 456 familje në gjendje shumë të mirë, janë refuzuar 352 dhe janë ende 104 pjesë e skemës së NE, ndërsa përse i përket familjeve që nuk janë gjendur në banesë nga 887, janë refuzuar 317 prej tyre dhe 570 janë ende aktive.

Nga 915 familje të klasifikuara si ekstremisht të varfra janë ndihmuar 168 familje me pako ushqimore, mjete shkollore dhe restaurime banesash.

Gjatë periudhës Shtator- Dhjetor 2024, janë kryer 9 kontrole tematike në njësitë administrative që kanë rezultuar me riskun më të lartë, Bilisht, Hociisht, Miras, Proger, Qëndër Bilisht, Pojan, Libonik, Çërravë dhe Pirg,. Gjatë kontroleve kanë rezultuar se 275 familje nuk janë paraqitur të gjithë anëtarët madhorë për deklarimin 3-mujor dhe në zbatim të legjislacionit të NE-së, në vendimmarrjen e muajit përkatës janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike me arsyen përkatëse.

Qarku Shkodër

Në qarkun Shkodër për periudhën Prill-Maj janë kryer gjithsej 3510 verifikime në banesë ose 80% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

Qarku	Bashkia	Nr. Verifikimeve NE+6%	Nr. Familjeve ekstremisht të varfra	Nr. Familjeve në kushte shumë të mira	Nr. i familjeve të cilat nuk u gjetën në banesë dhe nuk janë paraqitur pranë administratorit shoqëror
SHKODËR	Shkodër	1438	271	96	23
	Vau Dejës	759	146	25	5
	Malësi e Madhe	695	57	21	1
	Pukë	306	66	1	0
	Fushë Arrëz	312	121	0	3
	TOTALI 5	3510	661	143	32

Nga të dhënat si më sipër rezulton se nga 3510 familje te Qarkut Shkodër të verifikuara në terren:

- **3186 familje ose 96% e familjeve të verifikuara janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike,** nga të cilat 661 familje ose 19% janë familje ekstremisht të varfra.
- **143 familje ose 4% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të Skemës së Ndihmës Ekonomike,** pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara.

- 181 familje përfituese të ndihmës ekonomike nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit, nga të cilat 32 familje nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative.

Bashkia me riskun më të lartë dhe me më shumë problematika në qarkun Shkodër rezulton Bashkia Shkodër. Në këtë Bashki është konstatuar përqindja më e lartë e familjeve (4%), të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike, për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Shkodër ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë Task-Forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratat tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 32 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer dhe anëtarët madhorë të familjes nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative për të firmosur, janë refuzuar 11 familje, por 21 familje vijnë të jenë përfituese në skemë.

2. Për 143 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se janë refuzuar për periudhën Shkurt- Dhjetor 44 familje dhe vijnë të jenë përfituese por 109 familje vijnë të jenë përfituese në skemë.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se 171 familje në total janë mbështetur me paketa ushqimore, orientuar për bonusin e qerasë, rinovuar banesa, ofruar shërbim për PAK dhe të moshuarit, ndihmuar me mjete shkollore.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 5 kontrolle në njësitë Rrethina, Postribë të Bashkisë Shkodër, Vau Dejës dhe Bushat të Bashkisë Vau Dejës dhe Njësia Shkodër e Bashkisë Shkodër. Gjatë periudhës Shtator- Dhjetor 2024 janë refuzuar me arsyen mosparaqitje për deklaratë 3 mujore 15 familje.

Qarku Tiranë

Në qarkun Tiranë për periudhën Prill – Qershor 2024 janë kryer gjithsej 2305 verifikime në banesë të familjeve përfituese ose 93% të familjeve përfituese nga Skema e Ndihmës Ekonomike.

Qarku Tiranë, muaji Prill - Qershor 2024					
Qarku	Bashkia	Nr. i verifikimeve NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje me anëtarë madhorë jo prezent
Tiranë	Vorë	69	50	3	18
	Rrogozhinë	188	143	9	43
	Kavajë	219	173	8	90
	Kamëz	425	289	21	169
	Tiranë	1404	988	55	329
Totali	5 Bashki	2305	1643	96	649

- **1643 familje ose 94%** e familjeve të verifikuara janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat **408 familje ose 25% janë familje ekstremisht të**

varfra. Njësitë e bashkisë Tiranë janë njësitë me numrin më të lartë të familjeve në kushte ekstremisht të varfra, me rreth 23% të familjeve përfituese.

- **96 familje ose 6% e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike,** pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. Njësia Gosë e bashkisë Rrogozhinë, Lagja Bathore dhe Valias e bashkisë Kamëz dhe njësia Zall Bastar e bashkisë Tiranë janë njësitë me numrin më të lartë të familjeve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara.
- **649 familje ose 40% e familjeve të verifikuara që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale.**
- Nga 566 familje përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit rezultojnë se vetëm **2 familje nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësive administrative.**

Bashkia me risk më të lartë dhe me më shumë problematika rezultoi Bashkia Kamëz, ku 7% e familjeve përfituese në këtë bashki nuk plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike pasi kanë banesë me kushte të mira dhe nuk deklarojnë të ardhurat. **Njësia administrative Kamëz** kryesisht Lagja Bathore dhe Valias rezultojnë me numrin më të lartë të familjeve, ku **8 % e tyre nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike** për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara. **Në bashkinë Tiranë (njësia Zall Bastar)** rezultojnë me numrin më të lartë të familjeve që nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike, ku 21 % e tyre rezultuan në kushte shumë të mira të konstatuara.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Tiranë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratat tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 2 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezultojnë se, të dyja familjet janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike.

2. Për 96 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezultojnë se për periudhën Prill-Dhjetor janë refuzuar **94 familje** ndërsa 2 familje janë rivlerësuar si familje në nevojë dhe vijojnë të jenë përfituese.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezultojnë se në total janë ndihmuar 3910 familje, ku 3631 familje janë mbështetur me paketa ushqimore, për 26 familje është ofruar restaurim banesë, 214 kanë përfituar mbështetje monetare, 35 familje janë mbështetur me bonus qiraje dhe 4 familje janë mbështetur me banesë sociale.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 3 kontrolle në njësinë Zall Herr të Bashkisë Tiranë, në bashkinë Kamëz dhe në njësinë Zall Bastar të Bashkisë Tiranë. Në total janë kryer 141 deklarime 3 mujore nga të cilat rezultojnë se për 9 familje nuk janë gjeneruar deklaratat 3 mujore për arsye se nuk janë paraqitur anëtarët madhor për deklaram

Qarku Lezhë

Gjatë periudhës së task forcës Prill-Maj 2024 janë verifikuar gjithsej 2131 familje ose 83% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, ku rezultuan:

Qarku	Bashkia	Nr. i familjeve të verifikuara nga grupet Task Forcë	Nr. i Familjeve ekstremisht të varfra	Nr. i familjeve të gjetura në kushte të shumta të mira që nuk janë në kushtet e përfitimit të NE-së	Nr. i familjeve të cilat nuk u gjetën në banesë	Nr. i familjeve të cilat nuk u gjetën në banesë dhe nuk janë paraqitur pranë administratorit shoqëror brenda 48 orëve
Lezhë	Lezhë	724	153	8	108	25
	Kurbin	838	124	13	261	19
	Mirditë	569	149	1	81	14
Total	3 Bashki	2131	426	22	450	58

- **1659 familje ose 99 %** janë klasifikuar si familje në nevojë, ku prej tyre **426** ekstremisht të varfra.
- **22 familje ose 1%** e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale.
- **Nga 450 familje** familje përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit rezultoi se **58 prej tyre** nuk janë paraqitur pranë njësive administrative për firmë.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Lezhë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike. Nga 22 familje në gjendje shumë të mirë, janë refuzuar 18 prej tyre dhe 4 familje për shkak të situatës sociale të tyre janë vlerësuar për të qëndruar në skemë. Nga 58 familje të cilat, 50 janë refuzuar dhe 8 ende janë përfituese nga skema e ndihmës ekonomike. Gjithashtu në dhjetor janë shpërndarë 797 pako ushqimore nga Bashkia Lezhë për familjet në NE, 110 pako ushqimore nga bashkia Kurbin dhe 40 pako ushqimore nga Bashkia Mirditë.

Gjatë periudhës Shtator- Dhjetor 2024 janë refuzuar me arsyen mosparaqitje për deklaratën 3 mujore 39 familje. Janë kryer kontrolle në njësitë në 7 njësi administrative, përkatësisht në njësitë Laç, Fan, Shënkoll, Milot, Mamurras, Kolsh, Zejmen

Qarku Fier

Në qarkun Fier për periudhën Prill – Maj 2024 janë kryer gjithsej 1.114 verifikime social ekonomike në banesë për familjet përfituese ose rreth 80 % e familjeve ku janë konstatuar gjetje si më poshtë.

Bashkia	Nr. Verifikimeve të kryera	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje që nuk u gjenden në banesë	Familje ekstremisht të varfra
Divjak	114	94	2	18	43
Fier	307	260	15	32	74
Lushnje	221	122	4	95	76
Mallakaster	210	153		57	54
Patos	128	68	5	55	19
Roskovec	134	108	15	11	32
Total	1114	805	41	268	298

- **298 familje ose 26% e familjeve në nevojë**, ndodhen në gjendje ekstremisht të varfra.
- **41 familje ose 4% e familjeve nuk janë në kushtet e përfitimit** të ndihmës ekonomike, (nga këto 41 familje të gjendura në kushte shumë të mira, 16 familje janë larguar nga skema e NE në vendimarrjen e muajit përkatës gjatë së cilit është kryer verifikimi.
- **Për 268 familje të cilat nuk u gjenden në banesë, 38 familje ose rreth 4% e familjeve të verifikuara nuk janë paraqitur pranë njësive përkatëse për të firmosur.**

Bashkitë që kanë rezultuar me risk më të lartë krahasuar me Bashkitë e tjera nisur nga infrastruktura dhe mundësitë për të krijuar të ardhura apo punësuar **janë Bashkia Roskovec dhe Fier të cilat zënë rreth 40% të familjeve përfituese të qarkut Fier.**

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Fier ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontroleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratimet tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 38 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezulton se, 23 familje janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike pasi nuk janë paraqitur për deklarinimin 3 mujor ndërsa 15 familje janë rivlerësuar që duhet të jenë përfituese pasi ndodhen në kushte të vështira social ekonomike.

2. Për 41 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Prill-Shtator janë refuzuar të gjitha familjet nga skema e ndihmës ekonomike.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë ndihmuar 25 familje me paketa ushqimore.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë të cilat nuk janë kryer verifikimet gjatë task-forcës. Gjithsej janë kryer 2 kontrole tematike në njësitë Kurjan dhe Patos. Në total kanë pasur deklarinimin 3 mujor 51 familje nga të cilat rezulton se 51 familje janë paraqitur pranë njësive për të firmosur deklaratën 3 mujore.

Qarku Vlorë

Në qarkun Vlorë për periudhën Prill – Qershor 2024 janë kryer gjithsej 1515 verifikime social ekonomike në familje, ose 100% e familjeve përfituese në qarkun Vlorë.

Bashkia	Nr. Verifikimeve të kryera	Nr. Familjeve në gjendje shume të mirë	Nr. Familjeve që nuk u gjenden në banesë	Nr. Familjeve ekstremisht të varfra
Delvinë	163	1	2	52
Konispol	49	0	0	13
Sarandë	232	0	6	41
Finiq	42	1	5	5
Vlorë	627	6	10	162
Himarë	75	4	6	12
Selenicë	327	8	7	74
Total	1515	20	36	359

- **1312 familje ose 99% e familjeve janë në kushtet e përfitimit si familjeve në nevojë.**
- **20 familje janë konstatuar në kushte shumë të mira, ose 1% e familjeve nuk janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike.**

- **36 familje ose 2% e familjeve të verifikuara** nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit dhe nuk janë paraqitur pranë njësive administrative për të firmosur.

Qarku Vlorë, në tërësinë e tij nuk është qark që mbart risk për shkak se, në të gjitha Bashkitë trajtohet një numër relativisht i ulët i familjeve në ndihmë ekonomike, rreth 1% e familjeve në total qarkun. **Bashkia Delvinë është evidentuar Bashkia më e varfër në qarkun Vlorë**, rastet më të shumta të cilat jetojnë në kushte ekstremisht të varfra janë konstatuar po në këtë Bashki dhe i përkasin familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian dhe personave PAK si dhe moshë e mbetur i përket moshës së tretë, e cila nuk është në gjendje të punojë apo të krijojë të ardhura. Ndërsa në 5 Bashkitë e tjera Vlorë, Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, edhe pse janë Bashki të cilat ofrojnë mundësi punësimi me sezone, (punësimi sezonal i cili zgjat vetëm për muajt e verës por nuk u jep të ardhura të sigurta për gjithë vitin), përsëri ka shumë vështirësi në përballimin e jetesës. Përgjithsisht, përfituesit e Ndihmës Ekonomike në këto bashki janë familje të komunitetit romë dhe egjiptjan, familje me 1 anëtar, pensionistë dhe persona PAK dhe integrimi në tregun e punës është shumë i vështirë.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Vlorë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitet me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratimet tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 36 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezulton se, 34 familje janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike pasi nuk janë paraqitur për deklarin 3 mujor ndërsa 2 familje janë rivlerësuar që duhet të jenë përfituese pasi ndodhen në kushte të vështira social ekonomike.

2. Për 20 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Prill-Shtator janë refuzuar 19 familje dhe 1 familje është rivlerësuar për të qëndruar në skemë me dokumentacionin përkatës mbi problemet shëndetësore.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë mbështetur 145 familje, 29 familje kanë përfituar shërbim për subvencione qeraje, restaurim shtëpie, shtëpi të re ose kanë aplikuar për restaurim banese, 15 persona janë orjentuar për përgatitje dokumentacioni për Pagesën e Aftësisë së Kufizuar, 63 familje kanë përfituar pako ushqimore / veshmbathje, 25 persona janë orjentuar për punësim në AKPA, 13 familje kanë marrë shërbime të tjera, si psh shërbim ditor në banesë për të moshuar, bursa shkolle, qendër ditore për fëmijë etj

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitet të cilat nuk janë kryer verifikimet gjatë task-forcës. Gjithsej janë kryer 17 kontrolle, ku 10 kontrolle janë kryer të plotë në njësitet ,Kotë, Brataj, Vllahinë, Armen, Sevaster, Selenicë, Mesopotam, Livadhja, Konispol, Delvinë dhe 7 kontrolle tematike në njësitet Hore-Vranisht, Lukovë, Himarë, Markat, Xarrë, Ksamil, Sarandë. Në total kanë pasur deklarin 3 mujor 74 familje nga të cilat rezulton se 52 familje janë paraqitur pranë njësive për të firmosur dhe për 22 familje nuk janë gjeneruar deklaratat 3 mujore për arsye se nuk janë paraqitur për deklarin.

Qarku Berat

Qarku Berat përfshin në juridiksionin e tij 25 njësi administrative në 5 Bashki. **Gjatë periudhës së task forcës janë verifikuar 1146 familje ose 93% e përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike në qarkun Berat nga të cilat:**

Qarku Berat	Numri i Verifikimeve të kryera	Familje në nevojë	Familje në Gjendje shumë e mirë	Familje në gjendje Ekstremisht të varfër

Berati	403	377	22	108
Kuçovë	127	127	0	8
Poliçan	162	162	0	58
Dimal	121	119	2	35
Skrapar	332	332	0	57
5 Bashki	1146	1117	24	266

- **897 familje ose 97 %** janë klasifikuar si familje në nevojë
- **24 familje ose 3%** e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale.
- **Nga 225 familje** përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit rezultoi se **11 prej tyre** nuk janë paraqitur pranë njësisë administrative për firmë.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Berat ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike. Nga 24 familje në gjendje shumë të mirë, janë refuzuar 19 prej tyre dhe 5 familje janë ende aktive në skemë. Nga 11 familje të cilat, 5 janë refuzuar dhe 6 ende janë përfituese nga skema e ndihmës ekonomike. Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2024 janë refuzuar me arsyen mosparaqitje për deklaratën 3 mujore 41 familje. Janë kryer kontrolle në njësitë në 6 njësi administrative, përkatësisht në njësitë Qendër Skrapar, Vendreshë, Vërtop, Sinjë, Otlak dhe Kutalli.

Qarku Durrës

Në qarkun Durrës për periudhën Prill – Maj 2024 janë kryer gjithsej 675 verifikime në banesë ose 100% të familjeve përfituese nga Skema e Ndihmës Ekonomike.

Qarku Durrës, muaji Prill - Maj 2024					
Qarku	Bashkia	Nr. i verifikimeve NE+6%	Familje në nevojë	Familje në kushte shumë të mira	Familje me anëtarë madhorë jo prezent
Durrës	Krujë	455	321	8	129
	Shijak	61	38	0	14
	Durrës	159	135	1	14
Totali	3 Bashki	675	494	9	157

- **494 familje ose 98% e familjeve** të verifikuara janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat **47 familje ose 9.5 % e tyre janë familje ekstremisht të varfra**. Bashkitë Shijak dhe Krujë kanë rezultuar me numrin më të lartë të familjeve në kushte ekstremisht të varfra.
- **9 familje ose 2 % e familjeve të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike**, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruara si pasojë e emigrimit apo punës sezonale. **Njësia Thumanë** e bashkisë Krujë është njësia me numrin më të lartë të familjeve të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike për shkak të kushteve të mira të konstatuara.
- **Për 157 familje ose 32% e familjeve** të verifikuara që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nuk u gjend të paktën një anëtarë madhor present me arsye të ndryshme të pohuara nga familjarët si shëndetësore apo emigrimi/punë sezonale.
- **Nga 172 familje** përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit rezultojnë se **21 familje nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësisë administrative**.

Bashkia Krujë është bashkia me numrin më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të këtij qarku kjo pasi terreni i vështirë në disa prej njësive administrative dhe mungesa e infrastrukturës sjell vështirësi në punësimin për familjet të cilat kanë anëtarë në moshë madhore dhe aktive për punë. Gjithashtu Bashkia Krujë ka rezultuar me numrin më të lartë të familjeve në kushte ekstremisht të varfra.

Në bashkitë Shijak dhe Durrës numrin i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është më i ulët pasi janë zona fushore, turistike, me infrastrukturë të mirë si dhe kanë mundësi punësimi pranë bizneseve private kryesisht gjatë periudhës së verës.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Tiranë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë task forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratat tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 21 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer nga grupet e punës rezultojnë se në total janë refuzuar 18 familje dhe 3 familje janë rivlerësuar dhe vijnë të jenë përfituese në skemë.

2. Për 9 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezultojnë se për periudhën Prill-Dhjetor janë refuzuar të gjitha familjet e konstatuara me shkelje.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra janë dërguar listat në njësitë përkatëse, të cilat duhet të jenë prioritet për ndihma. Gjithashtu është komunikuar me organizatat të ndryshme për të ofruar mbështetje me pako ushqimore për këto familje.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer në total 8 kontrolle në njësitë Fushë Krujë, Krujë, Thumanë, Cudhi, Nikël, Bubq të bashkisë Krujë, Njësia Ishëm dhe Katund I Ri i bashkisë Durrës. Në total janë kryer 240 deklarime 3 mujore nga të cilat rezultojnë se për 17 familje nuk janë gjeneruar deklaratat 3 mujore për arsye se nuk janë paraqitur anëtarët madhor për deklarim ndërsa 2 familje janë në process rivlerësimi.

Qarku Gjirokastrë

Në qarkun Gjirokastrë për periudhën Shkurt-Maj janë kryer gjithsej 3510 verifikime në banesë ose 80% e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

Qarku	Bashkia	Nr. Verifikimeve NE+6%	Nr. Familjeve ekstremisht të varfra	Nr. Familjeve në kushte shumë të mira	Nr. i familjeve të cilat nuk u gjetën në banesë dhe nuk janë paraqitur pranë administratorit shoqëror
GJIROKASTËR	Memaliaj	317	44	16	26
	Tepelenë	104	9	8	0
	Këlcyrë	103	20	2	15
	Përmet	68	21	0	2
	Gjirokastrë	63	7	0	0
	Dropull	12	1	0	0
	Libohovë	8	0	0	0
	TOTALI 7	675	102	26	43

Nga të dhënat si më sipër rezulton se nga 698 familje të Qarkut Gjirokastrë të verifikuara në terren:

- **560 familje ose 96% e familjeve të verifikuara** janë konstatuar në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, nga të cilat 102 familje ose 15% janë familje ekstremisht të varfra.
 - **26 familje ose 4% e familjeve** të verifikuara nuk duhet të jenë përfituese të Skemës së Ndihmës Ekonomike, pasi jetojnë në kushte shumë të mira jetese dhe kanë të ardhura të padeklaruar.
 - Nga 112 familje përfituese të ndihmës ekonomike që nuk janë gjendur në banesë në momentin e verifikimit, **43 familje** nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësive administrative.
- **Bashkia me riskun më të lartë dhe me më shumë problematika në qarkun Gjirokastrë rezulton Bashkia Memaliaj.** Në këtë Bashki është konstatuar përqindja më e lartë e familjeve (5%), të cilat nuk duhet të jenë pjesë e përfitimit të ndihmës ekonomike, për shkak të kushteve shumë të mira të konstatuara.

Në zbatim të planit të masave për periudhën Shtator – Dhjetor 2024, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë ka vijuar me zbatimin e detyrave të lëna lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë Task-Forcës si dhe me kryerjen e kontrolleve tematike në njësitë me riskun më të lartë **kryesisht me deklaratat tre mujore** për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit.

1. Lidhur me 43 familjet të cilat nuk janë gjendur në banesë gjatë vizitës së kryer dhe anëtarët madhorë të familjes nuk janë paraqitur për të firmosur pranë njësive administrative për të firmosur, rezulton se, për periudhën Korrik - Dhjetor janë refuzuar në total 17 familje dhe 26 familje vijnë të jenë përfituese në skemë.

2. Për 26 familjet e konstatuara në gjendje shumë të mirë, rezulton se për periudhën Shkurt-Dhjetor janë refuzuar **11 familje** dhe 15 familje vijnë të jenë përfituese në skemë.

3. Për familjet e konstatuara në kushte ekstremisht të varfra rezulton se në total janë ndihmuar 153 familje janë ndihmuar me pako ushqimore, bonus qiraje dhe shërbime në banesë, 39 anëtarë të familjeve janë punësuar nga zyrat e punës nëpërmjet programit të punësimit/ kurse profesionale dhe 40 familjeve u është restauruar banesa.

4. Lidhur me kontrollet tematike për familjet që nuk janë gjendur në banesë gjatë verifikimit, janë kontrolluar deklaratat tre mujore në njësitë me riskun më të lartë. Gjithsej janë kryer 4 kontrolle në njësitë Qesarat, Krahës, Këlcyrë dhe Sukë. Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2024 nuk janë refuzuar familje me arsyen mosparaqitje për deklaratë 3 mujore.

II.Ecuria e skemës Janar-Dhjetor 2024/ Dinamika në nivel kombëtar

Ecuria e skemës së ndihmës ekonomike për periudhën Janar - Dhjetor 2024

-Gjatë vitit 2024 vihet re që numri i përfituesve në skemën e NE së , ka ulje të konsiderueshme gjatë muajve që ka ardhur si pasojë e hartëzimit dhe verifikimit në banesë të gjithë familjeve përfituese dhe papërgjegjshmërisë së njësive vendore gjatë proceduarve të aplikimit për përfitim dhe moskryerjes së verifikimit social ekonomik në banesë nga administratorët shoqërorë. Për vitin 2024 kanë përfituar ndihmë ekonomike mesatarisht 53.534 familje /indivdë në nevoj.

Qarqet me numrin më të lartë të përfituesve renditen, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë , qarqe të cilat kanë dhe shtrirjen gjeografike si dhe renditen si qarqe me nivelin më të lartë të varfërisë me përjashstim të qarkut të Korcës.

	Janar 2024			Shhkurt 2024			Mars 2024			Prill 2024			Maj 2024			Qershor 2024		
Bashkia	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues	Perfitues Fondi 6%	T
Qarku Berat	1171	133	1304	1183	130	1313	1173	130	1303	1177	133	1310	1192	130	1322	1168	130	
Qarku Diber	9238	819	10057	9043	845	9888	8883	843	9726	8763	816	9579	8732	859	9591	8649	824	
Qarku Durres	866	25	891	871	29	900	870	30	900	839	32	871	818	33	851	791	33	
Qarku Elbasan	12134	459	12593	12072	432	12504	11816	486	12302	11633	508	12141	11608	526	12134	11347	530	1
Qarku Fier	1586	133	1719	1575	154	1729	1565	152	1717	1566	148	1714	1554	152	1706	1518	144	
Qarku Gjirokaste	808	85	893	804	84	888	788	83	871	790	49	839	781	80	861	730	80	
Qarku Korce	7710	516	8226	7599	522	8121	7446	532	7978	7234	521	7755	7088	527	7615	6997	543	
Qarku Kukes	7524	686	8210	7449	720	8169	7318	692	8010	7266	691	7957	7284	703	7987	7286	710	
Qarku Lezhe	2542	330	2872	2537	330	2867	2500	325	2825	2423	315	2738	2411	319	2730	2325	304	
Qarku Shkoder	3969	451	4420	4006	478	4484	3974	479	4453	3965	483	4448	3971	485	4456	3916	492	
Qarku Tirane	3256	215	3471	3273	210	3483	3191	204	3395	3128	198	3326	3077	205	3282	3028	198	
Qarku Vlore	1550	73	1623	1585	93	1678	1555	92	1647	1527	100	1627	1509	98	1607	1484	97	
TOTALI	52354	3925	56279	51997	4027	56024	51079	4048	55127	50311	3994	54305	50025	4117	54142	49239	4085	5

	Korrik 2024			Gusht 2024			Shtator 2024			Tetor 2024			Nentor 2024			Dhjetor 2024		
Bashkia	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total Sistemi +6%	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6% Shtator 24	Total Sistemi +6%	Perfitues	Perfitues Fondi 6%	Total Sistemi +6%	Perfitues Sistemi	Perfitues Fondi 6%	Total Sistemi +6%	Perfitues Sistemi	Fondi 6%	Total Sistemi +6%
Qarku Berat	1137	67	1204	1136	128	1264	1113	131	1244	1115	124	1239	1096	128	1224	1094	130	1224
Qarku Diber	8568	805	9373	8608	818	9426	8612	839	9451	8519	873	9392	8535	926	9461	8559	835	9394
Qarku Durres	797	32	829	773	32	805	766	31	797	747	34	781	770	36	806	775	31	806
Qarku Elbasan	11322	506	11828	11340	525	11865	11214	513	11727	11140	512	11652	11119	529	11648	11098	474	11572
Qarku Fier	1488	151	1639	1463	145	1608	1426	144	1570	1444	146	1590	1460	142	1602	1460	117	1577
Qarku Gjirokastrë	729	83	812	723	83	806	709	80	789	711	81	792	706	79	785	725	74	799
Qarku Korce	6812	555	7367	6765	546	7311	6697	476	7173	6717	496	7213	6758	539	7297	6679	524	7203
Qarku Kukes	7317	700	8017	7255	678	7933	7113	709	7822	7114	718	7832	7125	704	7829	7110	678	7788
Qarku Lezhe	2321	308	2629	2276	300	2576	2224	303	2527	2195	297	2492	2245	293	2538	2296	299	2595
Qarku Shkoder	3916	463	4379	3924	478	4402	3865	487	4352	3832	480	4312	3835	482	4317	3806	448	4254
Qarku Tirane	2942	208	3150	2934	192	3126	2862	198	3060	2855	198	3053	2861	207	3068	2899	195	3094
Qarku Vlore	1436	96	1532	1425	85	1510	1403	88	1491	1418	102	1520	1442	104	1546	1436	77	1513
TOTALI	48785	3974	52759	48622	4010	52632	48004	3999	52003	47807	4061	51868	47952	4169	52121	47937	3882	51819

1.1.Dinamika e familjeve në NE sipas kategorive, përfitues/hyrje të reja të refuzuar

Muaji	Nr.Familje Perfituese Sistem	Nr.Familje perfituese 6%	Totali Familje Perfituese +6%	Kategorite	Total Perfitues	Hyrje te Reja	Refuzuar
Janar 2024	50057	3925	53982	2297	56279	1196	3957
Shkurt 2024	49681	4027	53708	2316	56024	835	2633
Mars 2024	48749	4048	52797	2330	55127	845	3071
Prill 2024	47911	3994	51905	2400	54305	880	2910
Maj 2024	47619	4117	51736	2406	54142	794	2290
Qershor 2024	46821	4085	50906	2418	53324	732	2574
Korrik 2024	46319	3974	50293	2466	52759	850	2551
Gusht 2024	46117	4010	50127	2505	52632	669	1865
Shtator 2024	45568	3999	49567	2436	52003	876	2551
Tetor 2024	45277	4061	49338	2530	51868	1012	2597
Nentor 2024	45424	4169	49593	2528	52121	780	1842
Dhjetor 2024	45371	3882	49253	2566	51819	795	1983

Muaji	Refuzuar Total	Refuzuar Mosparaqitje	% Total	Refuzuar Mosperputhje	% Total	Refuzuar Pikezim	% Total
Janar 2024	3967	665	17%	1683	42%	1619	41%
Shkurt 2024	2633	288	11%	997	38%	1348	51%
Mars 2024	3071	623	20%	1323	43%	1125	37%
Prill 2024	2910	817	28%	904	31%	1189	41%
Maj 2024	2290	264	12%	925	40%	1101	48%
Qershor 2024	2574	403	16%	1229	48%	942	37%
Korrik 2024	2551	494	19%	1002	39%	1055	41%
Gusht 2024	1865	164	9%	895	48%	806	43%
Shtator 2024	2551	257	10%	1372	54%	922	36%
Tetor 2024	2597	486	19%	960	37%	1151	44%
Nentor 2024	1842	174	9%	612	33%	1056	57%
Dhjetor 2024	1983	252	13%	801	40%	930	47%

Dinamika e refuzimeve sipas qarqeve

- Dinamika e refuzimeve si pasojë e deklarimeve jo të sakta gjatë aplikimeve, mosprezenca e familjeve/anëtarëve madhorë apo familje që nuk duhet të jenë pjesë e përfitimeve nga skema e ndihmës ekonomike, vihet re që është më e lartë në muajin Janar pasi numri i mospërputhjeve/deklarimeve tre mujore është më i lartë si dhe në muajin Mars e cila përkon direkt pas nisjes së task forcës në muajin shkurt.
- Qarqet që kanë refuzimet më të larta janë Elbasan, Dibër, Korçë dhe Kukës pasi janë Qarqe me numrin më të lartë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe përfaqësojnë 71% të familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike .

Qarku	Refuzime Total Janar 2024	Refuzime Total Shkurt 2024	Refuzime Total Mars 2024	Refuzime Total Prill 2024	Refuzime Total Maj 2024	Refuzime Total Qershor 2024	Refuzime Total Korrik 2024	Refuzime Total Gusht 2024	Refuzime Total Shtator 2024	Refuzime Total Tetor 2024	Refuzime Total Nentor 2024	Refuzime Total Dhjetor 2024	Mesatare
Berat	108	67	133	120	93	92	103	101	70	97	114	81	98
Diber	794	463	430	405	358	350	430	258	368	434	283	276	404
Durres	114	89	63	78	78	69	66	50	52	66	74	68	72
Elbasan	747	412	633	553	381	587	419	269	436	463	302	369	464
Fier	218	154	176	136	126	138	128	102	128	99	77	103	132
Gjirokaster	97	89	82	62	56	102	82	66	79	78	69	49	76
Korce	458	330	448	480	361	270	423	226	294	328	194	308	343
Kukes	400	279	315	224	167	195	200	223	387	224	149	152	243
Lezhe	253	183	183	270	147	234	182	197	175	212	131	117	190
Shkoder	262	198	254	182	154	222	140	139	232	223	176	222	200
Tirane	366	256	252	286	267	219	284	179	243	263	219	168	250
Vlore	140	113	102	114	102	96	94	55	87	110	54	70	95

III. Integrimin social i individëve në moshë aktive pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

gjatë vitit 2024 ka vijuar puna për integrimin dhe fuqizimin e familjeve në NE. Në zbatim të Urdhërit të përbashkët Nr.130, datë 05.03.2024 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar”, janë referuar te zyrat e punës 5844 anëtarë në moshë aktive pune , nga të cilët janë punësuar 2211 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, 609 të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit dhe adresuar për formim profesional 609 anëtarë në moshë aktive pune.

Mekanizmi I referimit dhe ndjekjes është përforcuar përmes takimeve dhe mbledhjeve periodike të komisioneve trepalëshe dhe kanë marrë vendime lidhur me mbarëvajtjen e procesit dhe vendime lidhur me refuzimet e shërbimeve të ofruara nga zyrat e punës duke trajtuar refuzimet me arsyet përkatëse.

Monitorim në 12 Qarqe dhe sipas planit të punës lidhur me komisionet trepalëshe nga Drejtoria e kontrollit të Pagesave NE dhe PAK

- Ndjekja me prioritet e ofertave nga AKPA për integrimin në programet e nxitjes së punësimit/formim profesional të anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të konstatuara nga task force duke i dhënë përparësi familjeve në gjendje ekstremisht të varfra .

Janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 271 familje, anëtarët e të cilëve kanë refuzuar 3 (tre) oferta për punësim, për 1257 familje komisionet kanë marrë vendim se duhet të vijnë në qendrojnë në skemë bazuar në kushtet social ekonomike/shëndetësore dhe problematika të ndryshme të cilat nuk i lejojnë të punësohen si dhe 656 familje janë në shqyrtim të dhënies së ofertave për punësim. Për personat me aftësi të kufizuar janë referuar te zyrat e punës 5901 individë si kategori PAK në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar/proces ndërmjetësi 328 individë dhe adresuar për formim profesional 143 individë.

VKM, Udhëzime dhe ndryshime ligjore gjatë vitit 2024

- Vendim Nr.8, datë 11.01.2024 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë, në furnizimin me gaz natyror dhe mënyrën e trajtimit të tyre”.
- Vendim Nr.152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”.
- Udhëzim Nr. 2, datë 26.3.2024 “Për miratimin e metodologjisë, për kriteret dhe

procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”.

- Urdhër i përbashkët Nr.130, datë 05.03.2024 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar”.
- Vendim Nr.854, datë 26.12.2024, “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2024”.

Referuar pikës 1, gërma a) dhe b)... të VKM-së së sipërcituar, përfitojnë shpërblim financiar për vitin 2024, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë 53.000 familje/individ në nevojë përfituese nga skema e ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor.

Vendim Nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar.

Risite në programin e NE-së, ndryshimet

- Ndërveprimi i sistemit të NE-së me sistemin e arsimit SMIP (arsimi). Si pasojë e ndërveprimit është rritur numri I fëmijëve në familjet e NE që përfitojnë subvencionin e arsimit të detyruar .
- Ndryshimi në sistem i kufirit të moshës nga 6 vjeç në 5 vjeç lidhur me përfitimin e pagesës për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm për anëtarët e familjeve përfituese
- Njoftimi i aplikantëve të NE-së nëpërmjet e-albania (familjeve përfituese ju dërgohet njoftim çdo muaj nga e-albania nëse janë përfitues ose jo të ndihmës ekonomike për muajin përkatës).
- Njoftimi nëpërmjet e-albania për tu regjistruar si punëkërkuar i papunë i aplikanteve që kanë mbushur 2 ose 4 vite përfitimi
- Verifikimi automatik i sistemit të NE-së me sistemin e PAK.
- Shtimi i një raporti për kontratën e Ujit në sistemin e NE-së për familjet/Individë përfitues për subvencionimin e tarifës së UK
- Shërbimi online në e-albania, Vërtetim negativ për Familje/Individë që nuk janë përfitues nga skema e ndihmës ekonomike
- Propozuar ofrimi i shërbimit online në e-albania lidhur me aksesimin e Vërtetimit si përfitues ose jo përfitues për Familje/Individë nga fondi 6%.
- Shërbimi online në e-albania, Vërtetim negativ për Individë që nuk janë përfitues të pagesës së PAK

Konsolidimi i skemës së ndihmës ekonomike me anë të mirëadministrimit të regjistrimit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

- Monitorimi i sistemit të Ndihmës Ekonomike. Analizimi dhe ndjekja e problematikave të raportuara nga përdoruesit tek kompania e mirëmbajtjes në platformën e suportit.
- Përpunim raportesh statistikore, të nxjerra nga sistemi i Ndihmës Ekonomike, në lidhje me familjet aplikuese, përfituese, të refuzuara etj.

- Ndjekja e ecurisë së verifikimeve si dhe udhëzime të vazhdueshme drejtorive rajonale lidhur me trajtimin e mospërputhjeve për përfituesit ekzistues dhe aplikuesit e rinj.
- Ndjekja e procesit të vendimmarrjes së Drejtorive Rajonale. Përgatitur tabelat statistikore progresive për muajt Janar-Dhjetor 2024, përfitues, refuzuar, refuzuar për mospërputhje, refuzuar për pike, hyrje të reja, kategori të veçanta etj.
- Monitoruar raporti i fondit 6%, në sistem dhe komunikuar me Drejtoritë Rajonale për mbylljen e procesit të rekomandimeve në afatin e sistemit. Komunikuar me Drejtoritë Rajonale në lidhje me problematikat e rekomandimeve në fondin 6%
- Realizuar ndërveprimi i sistemeve me SMIP dhe PPAK

Problematika në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Ndhmës Ekonomike:

- Aksesimi i raporteve është vetëm në formatin vieë, pdf dhe ëord. Të gjithë raportet për të gjithë përdoruesit nuk mund të shkarkohen në formatin excel. Nuk janë krijuar raporte të tjera statistikore, që të shërbenin për qëllime statistikore, duke qenë se raportet nuk shkarkohen në excel.
- Për shkak të moslejimit të copy-paste në sistem, nuk mund të kopjohet arsyeja e detajuar e mospërputhjes së ardhur nga ndërveprimi i sistemeve në panelin e verifikuesit dhe vendimmarrësit, gjatë trajtimit të mospërputhjeve apo refuzimit të aplikimit. Një zgjidhje e sugjeruar ka qenë që të përdorin një arsye standarte sipas intitucioneve nga vjen mospërputhja.
- Problematik komunikimi në sistemin e NE-së me sistemin e DPSHTRR-së , pasi janë konstatuar në sistem familje të cilat aktualisht nuk e disponojnë më mjetin, por nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR rezultojnë se mjetet motorrike i kanë në pronësi
- Probleme gjatë dërgimit të skedave nga DR SHSSH drejt AKPA-së, sistemi i AKPA nuk i pranonte, pas komunikimit me IKUB, problemi qëndronte në sistemin AKPA.
- Informacion jo i rregullt nga ndërveprimi sistemit të DPGJC-së në sistemin e NE-së
- Probleme gjatë verifikimit automatic me ISSH, pasi nuk ka informacion lidhur me përfituesit
- Probleme gjatë verifikimit automatic me sistemin e SMIP (arsimi) për muajt Maj, Qershor dhe Shtator pasi informacioni ka ardhur jo i plotë duke mos e lejuar familjen/individin të përfitojë pagesën e arsimit për anëtarin që ndjek arsimin e deturueshëm
- Konstatuar problematika me fondin 6 % lidhur me riaplikimet në sistemin e NE, ka pasur raste që kanë pasur vështirësi riaplikimi pasi kanë marrë statusin rekomanduar, duke mos qenë rekomaduar për muajin respektiv. Gjithashtu problem janë rastet kur duhet të riaplikojë në sistem, por duke qenë se sistemi nuk lejon të kesh aplikim me statusin rekomanduar apo përfitues, aplikuesit në rast riaplikimi në sistem, duhet të humbin një muaj përftimi 6%, pavarësisht se refuzohen nga sistemi. Aplikimet e fondit 6 % nuk verifikohen automatikisht, në momentin që vazhdojnë të jetë përfitues të fondit 6 %, duke bërë që të kenë periudha të gjata mosverifikimi.

Prioritetet/Sfidat

- Monitorim, kontroll dhe ndjekje mbi zbatimin e legjislacionit si dhe ndjekja e detyrave në DRSHSSH dhe njësitë vendore për vitin 2025 duke i dhënë prioritet masave të lëna nga gjetjet e task forcës.
- Kontrolle të skemës së NE në 12 qarqet, për DR SHSSH që nuk janë kontrolluar gjatë vitit 2024 por duke i dhënë prioritet njërive në qarqet me riskun më të lartë të konstatuara gjatë task forces 2024, qarqet Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë, duke qënë qarqet me numrin më të lartë të përfituesve.
- Ndjekja e rekomandimeve të lëna në Planin e masave lidhur me gjetjet e Task-Forcës, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 46, datë 30.01.2024, “Për krijimin e Task Forcës për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike”, me qëllim pasqyrimin e saktë të situatës së nevojës për ndihmë ekonomike në vend, vlerësimin e skemës së NE, monitorimi i mirëfilltë i punës së administratorëve shoqërorë dhe gjithë zinxhirit të institucioneve të ndërlidhura në reformën e NE-së në të gjithë vendin.
- Monitorimi i punës së administratorëve shoqërorë, takime kualifikuese gjatë vitit lidhur me procedura të përmirësuara në Regjistrin Elektronik të NE-së si dhe ndryshimeve ligjore në VKM-në nr. 597/2019.
- Monitorim dhe ndjekje e procesit të komisioneve tre palëshe lidhur me ofrimin e ofertave për punësim/formim profesional nga AKPA për anëtarët në moshë aktive pune duke i dhënë prioritet familjeve të konstatuara në gjendje ekstremisht të varfra jo vetëm në zonat urbane por edhe ata që jetojnë në zonat rurale të aksesueshme.
- Monitorim dhe kontroll në njësitë vendore të cilat janë zona kufitare ku është konstatuar një numër shumë i lartë i anëtarëve madhorë jo present (kontroll i dokumentacionit, vërtetimi hyrje-dalje i cili meret nga e-albania).

Aftësia e Kufizuar

Zbatimi i legjislacionit të PAK pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, plotësimi i detyrimeve nga DRSHSSH dhe OSHKSH në përputhje me legjislacionin e aftësisë së kufizuar në fuqi. Raportet janë bazuar në hapat e përcaktuara në përputhje me Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar.

Gjatë vitit 2024 sipas planit të punës dhe Urdhrit Nr.63 datë 08.02.2023 “ **Kontrollin e skemës së vlerësimit Bio-Psiko-Social të përfituesve të aftësisë së kufizuar** ” janë kontrolluar gjithsej **18 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar** pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror **Gjirokastrë, Kukës, Elbasan, Durrës dhe Tiranë (Proçes)**, përkatësisht :
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë

Drejtoria Rajonale Gjirokastrë ka në juridiksionin e saj 1 Komision Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga kontrolli i **200 dosjeve nga** (përfitues nga skema e vjetër dhe për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar **Gjirokastrë** u konstatua se në zbatim të **VKM Nr.722, datë 11.11.2019, pika 2,3, në të gjitha dosjet** ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit të mjekut të familjes dhe mjekut specialist, si dhe formulari i vlerësimit.

1. Mungon vula e institucionit në 78 formularë të plotësuar nga mjekët referues (mjekë familje/specialist).

2. Në 12 dosje mungon dokumentacioni mjekësor/ekzaminimet/vlerësimet për pacientët sipas udhëzuesit bio-psiko-social.

3. Në 1 dosje rezulton që diagnoza është hedhur gabim në sistem pasi tjetër diagnozë është shënuar nga mjeku specialist në formular dhe tjetër diagnozë është hedhur në sistem.

4. Në 7 dosje niveli i përfitimit të përcaktuar nga komisioni është mbi nivelin e vështirësisë të përcaktuar nga mjeku specialist.

5. Në 5 dosje afatet janë lidhur gabim duke sjellë pasojë humbjen e pagesës 1 muaj për përfituesin.

6. Në 3 dosje përfituesish rezulton që diagnoza është jashtë kriterëve të përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit bio psiko-social.

7. Mungonin kartelat shëndetësore të 19 pacientëve të referuar nga mjekët specialist për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

8. Rezultojnë 37 raste me parregullsi në dokumentacion, procedurë dhe nivel përfitimi, të cilat duhet të rivlerësohen në komisionin e nivelit më të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Dëmi ekonomik i shkaktuar në total është 208,782 Lekë, për 3 përfitues për të cilët nuk duhej të realizohej procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në udhëzuesin bio psiko social.

10. Bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar grupi i kontrollit ka të drejtë të dërgojë për vlerësim në komisionin e shqyrtimit të ankesave rastet që kanë rezultuar me parregullsi gjatë procesit të kontrollit.

Për 37 rastet e konstatuara me parregullsi e rasteve të kontrolluara të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtoria Rajonale Kukës

Drejtoria Rajonale Kukës ka në juridiksionin e saj 2 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga kontrolli i **300 dosjeve nga** (përfitues nga skema e vjetër dhe për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar **Spitali Kukës dhe Spitali Tropojë** u konstatua se në zbatim të **VKM Nr.722, datë 11.11.2019,**

pika 2,3, në të gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit të mjekut të familjes dhe mjekut specialist, si dhe formulari i vlerësimit.

1. Mungon vula e institucionit në 94 formularë të plotësuar nga mjekët referues (mjekë familje / specialistë).

2. Në 79 dosje mungon dokumentacioni i plotë mjekësor/ekzaminimet e pacientëve sipas udhëzuesit bio-psiko-social.

3. Në 15 raste komisionimi është realizuar jashtë afatit 30 ditor.

4. Në 13 rast diagnoza është hedhur gabim në sistem.

5 . Dëmi ekonomik i shkaktuar në total është 1.350705 Lekë, për 22 përfitues për të cilët nuk duhej të realizohej procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në udhëzuesin bio psiko social.

6. Për 2 përfitues afati i përfitimit është përcaktuar me efekt prapaveprues, duke sjellë një dëm ekonomik në vlerën 20.028 lekë.

7. Mungonin kartelat shëndetësore të 64 pacientëve të referuar nga mjekët specialist për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

8 . Bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar grupi i kontrollit ka të drejtë të dërgojë për vlerësim në komisionin e shqyrtimit të ankesave rastet që kanë rezultuar me parregullsi gjatë procesit të kontrollit.

Për 85 rastet e konstatuara me parregullsi e rasteve të kontrolluara të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtoria Rajonale Elbasan ka në juridiksionin e saj 6 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga kontrolli i **1170 dosjeve nga** (përfitues nga skema e vjetër dhe për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar **Spitali Elbasan, Qendra Shëndetësore Nr.1 Elbasan, Qendra Shëndetësore Gostimë, Qendra Shëndetësore Pajovë, Spitali Gramsh dhe Poliklinika e Specialiteteve Librazhd** u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, **pika 2,3, në të gjitha dosjet** ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit të mjekut të familjes dhe mjekut specialist, si dhe formulari i vlerësimit.

1. Mungon vula e institucionit në 115 formularë të plotësuar nga mjekët referues (mjekë familje / specialistë).

2. Në 120 dosje mungon dokumentacioni i plotë mjekësor/ekzaminimet e pacientëve sipas udhëzuesit bio-psiko-social.

3. Në 23 raste komisionimi është realizuar jashtë afatit 30 ditor.

4. Në 5 rast diagnoza është hedhur gabim në sistem.

5 . Dëmi ekonomik i shkaktuar në total është 946.884 Lekë, për 14 përfitues për të cilët nuk duhej të realizohej procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në udhëzuesin bio psiko social.

6. Për 8 përfitues afati i përfitimit është përcaktuar me efekt prapaveprues, duke sjellë një dëm ekonomik në vlerën 203.540 lekë.

7. Mungonin kartelat shëndetësore të 84 pacientëve të referuar nga mjekët specialist për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

8 . Bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar grupi i kontrollit ka të drejtë të dërgojë për vlerësim në komisionin e shqyrtimit të ankesave rastet që kanë rezultuar me parregullsi gjatë procesit të kontrollit.

Për 160 rastet e konstatuara me parregullsi e rasteve të kontrolluara të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtoria Rajonale Durrës ka në juridiksionin e saj 3 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga kontrolli i **506 dosjeve nga** (përfitues nga skema e vjetër dhe për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar **Komisioni Nr.1, Komisioni Nr.2 pranë Q.Sh.Nr.2 Durrës dhe Komisioni Qendra Shëndetësore Krujë** u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, pika 2,3, në të gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit të mjekut të familjes dhe mjekut specialist, si dhe formulari i vlerësimit.

1. Mungon vula e institucionit në 86 formularë të plotësuar nga mjekët referues (mjekë familje / specialistë).

2. Në 62 dosje mungon dokumentacioni i plotë mjekësor/ekzaminimet e pacientëve sipas udhëzuesit bio-psiko-social.

3. Në 76 raste komisionimi është realizuar jashtë afatit 30 ditor.

4 . Dëmi ekonomik i shkaktuar në total është 775.149 Lekë, për 4 përfitues për të cilët nuk duhej të realizohej procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në udhëzuesin bio psiko social.

5. Mungonin kartelat shëndetësore të 57 pacientëve të referuar nga mjekët specialist për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

6 . Bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar grupi i kontrollit ka të drejtë të dërgojë për vlerësim në komisionin e shqyrtimit të ankesave rastet që kanë rezultuar me parregullsi gjatë procesit të kontrollit.

Për 56 rastet e konstatuara me parregullsi e rasteve të kontrolluara të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtoria Rajonale Tiranë ka në juridiksionin e saj 6 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga kontrolli i **900 dosjeve nga** (përfutës nga skema e vjetër dhe për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar **Komisioni Bio-Psiko-Social me vendndodhje pranë Qendrës së Zhvillimit Kombinat, Komisioni Bio-Psiko-Social me vendndodhje pranë Dispancerisë Tiranë, Komisioni Bio-Psiko-Social me vendndodhje pranë Poliklinikës së Specialiteteve Nr.1, Komisioni Bio-Psiko-Social me vendndodhje pranë Poliklinikës së Specialiteteve Nr.3, Komisioni Bio-Psiko-Social me vendndodhje pranë Q.Sh Nr.10** u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, pika 2,3, në të gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit të mjekut të familjes dhe mjekut specialist, si dhe formulari i vlerësimit.

1. Mungon vula e institucionit në 10 formularë të plotësuar nga mjekët referues (mjekë familje / specialistë).

2. Në 11 dosje mungon dokumentacioni i plotë mjekësor/ekzaminimet e pacientëve sipas udhëzuesit bio-psiko-social.

3. Në të gjitha rastet komisionimi është realizuar brenda afatit 30 ditor.

4. Mungonin kartelat shëndetësore të 16 pacientëve të referuar nga mjekët specialist për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

Përmbledhje e kontrolleve

Nga kontrolli i ushtruar në këto 17 Komisione Vlerësimi janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë:

Nga kontrolli me përzgjedhje nga sistemi i **3.076 dosjeve fizike** të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Drejtoritë Rajonale **Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Kukës dhe Tiranë** u konstatua se në zbatim të VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019, pika 2,3 ndodhet karta e identitetit (çertifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjekësor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.

Në 284 dosje mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “ Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksonimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, **ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjekësorë plotëson standartet për vlerësimin** dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. *Grrupi i kontrollit ka lë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitim të aftësisë së kufizuar si dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmijë.*

Për 45 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kriterëve.

Mjekët e familjes dhe mjekët specialist kanë plotësuar formularët në kundërshtim me

Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Dëmi ekonomik i shkaktuar në total për 45 raste është 3.301.548 Lekë.

Është lënë detyrë shpërblimi e dëmit nga zyrrarët që e kanë shkaktuar, përkatësisht për rastet jashtë kriterëve shpërblimin e dëmit nga Mjeku i Komisionit. Për rastet kur e drejta e përfitimit është dhënë me prapaveprim shpërblimin e dëmit nga Mjeku i Komisionit, Punonjësi Social dhe Përgjegjësi i Komisionit. Kjo në zbatim të pikës 2 të nënit 28 të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH”, i ndryshuar dhe të pikës 17, shkronja (c) të Vendimit nr. 257, datë 05.05.2021, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale.

Për rastet kur diagnosa nuk përfshihet në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social, grupi i kontrollit ka lënë detyrë të rivlerësohen nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

Në 19 dosje Diagnoza është hedhur gabim në sistem, pasi tjetër diagnozë ka shënuar mjeku specialist në formular dhe tjetër diagnozë është hedhur në sistem.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Mjeku i zyrës së Vlerësimit Bio-Psikosocial, i cili duhet të verifikojnë dokumentacionin mjekësor të aplikantëve që në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, të hedhë në sistem diagnozën e saktë ashtu siç e ka plotësuar mjeku specialist dhe për rastet jashtë kriterëve të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të mos kryejnë procedurën e vlerësimit. DRSHSH të njoftojë zyrtarisht aplikantin.

Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 3.076 dosjeve rezulton se janë shkelur afatet e komisionimit për 114 aplikantë, kjo në kundërshtim me VKM Nr.722 ,datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d:

Stafi i zyrës së vlerësimit ka këto detyra :

Organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Zyra e Vlerësimit me zbatimin e VKM Nr.722 , datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d: Ku stafi i zyrës së vlerësimit organizon dhe kryen intervistën brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjeksore. Nga kontrolli rezultoi se mungoni kartetat për 221 raste.

Kjo në kundërshtim me VKM Nr.257, datë 05.05.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale” pika 12, gërma c ku shprehet se:

Për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, grupi i kontrollit në nivel qëndror kontrollon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e procesit të referimit nga strukturat shëndetësore, përfshirë kontrollin e kartelës shëndetësore, përputhshmërinë e diagnozës dhe

kohës së fillimit të sëmundjes me përshkrimet në formularët e referimit, referimin nëpërmjet sistemit dhe recetën elektronike.

*Grupi i kontrollit ka njoftuar **Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në lidhje me detyrimet** që kanë Mjekët specialist dhe Mjekët e familjes pasi duhet të përcaktojnë diagnozën kryesore të pacientit sipas emërimit në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmijë dhe ta mbështesë këtë diagnozë mbi të gjitha ekzaminimet dhe dokumentacionin mjekësorë të përcaktuar në udhëzues, e dokumentuar në kartelën shëndetësore.*

Për 338 rastet e konstatuara me parregullsi në dokumentacion është lënë detyrë të bëhet rivlerësimi nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Grupi i kontrollit ka lënë detyrë të rivlerësohen nga Komisioni Shumëdisiplinor i nivelit më të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 63, datë 08/02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

Aftësia e Kufizuar									Kontrolli i skemës			
Nr.	Qarku	Mungon dokumentacioni mjekësor sipas udhëzuesit	Diagnoza hedhur gabim në sistem	Diagnoza jashtë kriterëve Efekt Financiar dhe efekt prapaveprues	Nuk është respektuar afati 30 ditor komisionimit	Dërgohen në KSHA për parregullsi dokumentacioni	Mungonin kartelat mjekësore OSHKSH	Muaji/viti kur ka filluar zbatimin i skemës së re	Numri i dosjeve të kontrolluara	Numri i PAK abuziv	Dëmi ekonomik	Masat e marra
1	Berat							Dhjetor 2022				
2	Dibër							Janar 2023				
3	Durrës 2024	62	0	4	76	56	57	Shtator 2021	506 dosje (3 komision)	4	775,149	Shpërblim Dëmi
4	Elbasan 2024	120	5	14	23	160	84	Shtator 2021	1170 dosje (6 komision)	14	946,884	Shpërblim Dëmi
5	Fier							Nëntor 2022				
6	Gjirokastrë 2024	12	1	3	0	37	0	Janar 2023	200 dosje (1 komision)	3	208,782	Shpërblim Dëmi
7	Korçë							Gusht 2022				
8	Kukës 2024	79	13	24	15	85	64	Janar 2023	300 dosje (2 komisione)	24	1,370,733	Shpërblim Dëmi
9	Lezhë (Tematik)							Qershor 2022				
10	Shkodër							Qershor 2022				
11	Tiranë 2024	11	0	0	0	0	16	Dhjetor 2019	900 dosje (5 komision)			
12	Vlorë							Qershor 2022				
Total		284	19	45	114	338	221		3076 dosje (17 komision)	45	3,301,548	

Administrimi i Regjistrimit Elektronik të PPAK.

- Është realizuar administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike PAK (Vlerësimim Bio-Psiko-Social) dhe Arkiva.

- Përditësime në Regjistrin Elektronik të PPAK i të gjitha zyrave të vlerësimit si dhe akseset për të gjithë njësitë vendore, sipas kërkesave të bëra.
- Krijime dhe përditësime të userave me rolet përkatëse.
- Konfigurim VPN.

Përditësimi i Arkivës Elektronike PPAK.

Gjatë vitit 2024 në sistemin e PPAK është realizuar:

- *Integrimi i sistemit PPAK me sistemin e arsimit SMIP*

Për të optimizuar procesin e verifikimit të ndjekjes së arsimit për aplikantët e sistemit PPAK është zhvilluar integrimi me sistemin e arsimit SMIP. Integrimi me këtë sistem mundëson marrjen e informacionit për aplikantët mbi ndjekjen e gjimnazit apo një shkollë profesionale, pa qenë nevoja e paraqitjes së dokumentave shtesë nga aplikanti.

II. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në zbatim të ligjit 121/2016 “ Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2024 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

OBJEKTIVI I

ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS LEGJISLACIONIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Për realizimin e këtij objekti u realizuan aktivitetet e mëposhtëme:

- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
 - *Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; Moshimit, Viktimat e krimit, Dhunën në familje, të miturit në konflikt me ligjin..*
 - *Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.*
 - *Propozime për rishikimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore dhe ngritjen e shërbimeve të reja konkretisht për moshimin dhe PAK*
- Për vitin 2024 harta e shërbimeve sociale është përditësuar dhe nga mbledhja e informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Sociale Shtetërore rezulton se është zgjeruar me 16 shërbime të reja, kryesisht 9 shërbime për aftësinë e kufizuar, 6 për persona të moshuar dhe 1 shërbim multifunksional kryesisht për fëmijë.
- Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Sociale Shtetërore në muajin qershor 2024 është evidentuar se në 61 bashki të vendit 21 bashki u ka përfunduar afati i planeve sociale. Në vazhdim DSHS do të ndjek bashkërendimin e këtyre planeve sociale. Nga mbledhja e informacionit rezulton se për vitin 2024 funksiononin 14 NJNVR.
- Në zbatim të Ligjit Nr 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Organizatën PNUD ka realizuar “Hartëzimin e shërbimeve Sociale” për vitin 2023. Ky raport është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga Bashkitë e vendit dhe konkretisht mbi:
 - *Të dhënat mbi shërbimet shoqërore dhe shpërndarja e tyre në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.*
 - *Të dhënat mbi shërbimet sipas llojit, mënyrës së menaxhimit, financimit, tipologjisë së shërbimeve dhe grupeve përfituese.*

- *Të dhëna mbi shkallën e plotësimit të nevojës për shërbime sipas grupeve në situatë kritike, sipas rajoneve dhe bashkive të vendit.*

▪ **Procesi i Deinstitutionalizimit**

Procesi i Deinstitutionalizimit ka avancuar gjatë vitit 2024 me trajnimet e stafëve të IPSH-ve Vlorë, Korçë, Tiranë, Durrës dhe Shkodër, mbi DI, mbi shërbimet e reja në institucion, me mbështetjen e UNICEF . Është miratuar metodologjia e Transformimit të IPSH 0-5 vjeç Vlorë dhe është duke u punuar për transformimin e këtyre dy institucioneve.

Në zbatim të planit të DI, Shërbimi Social Shtetëror ka hartuar Strategjinë e Komunikimit me qëllim sensibilizimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve / fuqizimin e familjeve etj. Në vijim të Strategjisë së Komunikimit SHSSH ka hartuar një plan aktivitetesh për këtë fushatë. Gjatë vitit 2024 janë realizuar në 18 Bashki të vendit takime sensibilizuese me të gjithë aktorët që operojnë në fushën e shërbimeve sociale, si dhe shpërndarje fletpalosjesh për DI, në Njësitë Vendore.

Gjatë vitit 2024 Shërbimi Social Shtetëror ka lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit për avancimin e procesit të DI me Bashkinë Shkodër, Drejtorinë Rajonale të SHSSH Shkodër , Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç Shkodër si dhe organizatën Nisma/Arsis ku synohet zgjerimi i shërbimeve komunitare për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve , përmes fuqizimit të familjeve dhe shërbimeve të kujdesit alternativ me bazë familjen dhe komunitetin si një nga qëllimet politike kryesore të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2024-2030.

Procesi i Deinstitutionalizimit po avancohet dhe për personat me aftësi të kufizuara. Në zbatim të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është realizuar procesi i vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara në Qendrat e Zhvillimit Berat, Korçë dhe Shkodër për të vlerësuar potencialin që ata bartin për punësim, formim profesional apo jetesë të pavarur. Procesi i vlerësimit është pjesë e planeve të de-institutionalizimit , me fokus të veçantë riintegrimin e tyre nëpërmjet punësimit.

Si rrjedhojë Shërbimi Social Shtetëror ka koordinuar punën me ekspertët dhe institucionet që kanë rol në zbatimin e këtij procesi si Drejtori Rajonale të Shërbimeve Sociale, Bashki, Zyra Punësimi si dhe Qendra të Formimit Profesional.

- Trajnimi i personelit të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar dy trajnime me stafet e Institucioneve Rezidenciale për të Moshuar, si më poshtë:

- Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar bashkëpunimin me European Commission, Sue Ryder Care Albania dhe Bashkinë e Tiranës për trajnimin e Përgjegjësve Socialë dhe Psikologëve të institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit, trajnim 3 (tre) ditorë (20, 21 dhe 22 maj 2024), me temë “Fuqizimi i kujdesit për të moshuarit: Një qasje gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve të mirëkoordinuara për të moshuarit”.
- Shtëpia e të Moshuarve Shkodër në bashkëpunim me organizatën “Help for life” ka organizuar trajnimin e stafit gjatë muajit dhjetor, mbi temën “ Kujdesi mjekësor për të moshuarit”, trajnim i akredituar.

- Trajnimi I stafeve të IPSH për fëmijë në lidhje me tema të ndryshme nga organizata të ndryshme si “ trauma dhe llojet e saj”, “Atashimi dhe pasojat e atashimit të sigurtë”, “ Një jetë e shëndetshme në komunitet” organizuar nga Swiss Kontakt etj, riintegrimi ekonomik për viktimat e trafikimit nga UNICEF dhe UK Government, ‘Sesion edukimi për të miturit në konflikt me ligjin’ në 4 IPSH për fëmijë rezidenciale.
- Trajnimet e stafeve të institucioneve mbi DI dhe shërbimin emergjent, në mbështetje të UNICEF , me stafet e IPSH-ve Vlorë , Korçë, Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

BJEKTIVI II

ZHVILLIMI I PËRKUJDESJES ALTERNATIVE

DSHS në SHSSH për realizimin e këtij objektivi ka planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;

Për vitin 2024 janë realizuar nga sektori i shërbimeve për fëmijë, bazuar në kalendarin vjetor të monitorimeve 7 monitorime në Institucionet e Përkujdesit për Fëmijë dhe QKTE. Nga monitorimi janë konstatuar këto problematika në 7 IPSH-të e fëmijëve dhe QKTE.

- ✚ Mungesa e investimeve në përmirësimin e kushteve fizike të godinave, kryesisht në institucionet me kapacitet të madhe si Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë, Tiranë Shkodër dhe Shtëpia e Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër.
- ✚ Rikthim në familje i fëmijëve është bërë i vështirë për shkak të kujdestarisë me vendim gjykatë, i cili zgjat procedurën dhe kohën e rikthimit në familje. Janë ndjekur rreth 20 seanca gjyqësore për fëmijet e vendosur me Masë Mbrojtje nga Gjykata e Tiranës nga specialistët e sektorit të fëmijëve, **Nga analiza vjetore statistikore tregon se numri i fëmijëve në familje biologjike ka rënë me 50 %.**
- ✚ Nga të dhënat e raportuara rezulton se ka shtim të rasteve të fëmijëve të referuar dhe trajtuar në IPSH-të me probleme të shëndetit mendor si çrregullime të sjelljes, ADHD, çrregullime në të nxënë dhe të vëmendjes. **Gjithsej rezultojnë se janë në total 42 fëmijë me probleme të shëndetit mendor të diagnostikuar nga specialistët.**
- ✚ Rishikimi i strukturave organizative në disa IPSH të fëmijëve. Në disa institucione mungon figura e psikologut por edhe e infermierit. Është e nevojshme edhe shtim i stafit me kujdestare apo staf edukator për të plotësuar nevojat në përmirësimin e shërbimit sipas standardeve.
- ✚ Në shtëpinë e Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër duhet të ndryshojë në tërësi organizimi i shërbimit në përputhje me qëllimin duke ndryshuar dhe përshtatur infrastrukturën e godinës me qëllimin e shërbimit. Gjithashtu nevojitet ndryshim në strukturën organizative duke përfshirë staf kujdestar dhe staf mbështetës të cilët mungojnë.
- ✚ Në kuadër të reformës së Deinstitutionalizimit, Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Vlorë nuk ka asnjë fëmijë, dhe Shtëpia e Fëmijës Korçë ka vetëm 1 fëmijë ku 2 prej tyre kanë kaluar në familje kujdestare pa lidhje gjaku foster- care në 10 Janar 2025 dhe 1 fëmijë është transferuar në IPSH. **Të dy IPSH-të janë në proces për transformim e tyre me shërbime të reja.**
- ✚ Implementim i standardeve të reja dhe trajnimi i stafit në lidhje me zbatimin e tyre.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 5 monitome në institucionet rezidenciale publike për të moshuar dhe konkretisht në Fier, Poliçan, Tiranë, Gjirokastrë dhe Shkodër.

Problematikat e nxjerra janë:

- ✚ Mos zbatim të VKM-së 518/2018 nga bashkia Fier në të gjitha rastet e sistemimeve të moshuarve në institucion.
- ✚ Mungesa e rojes në institucion si Gjirokastrë, Tiranë etj.
- ✚ Ndërhyrje në infrastrukturë si ,mungesa e një ashensori;(Fier dhe Gjirokastrë) Ashensori jo funksional;(Poliçan),jo funksional sistemi i alarmit në rast zjarri;
- ✚ Të hidhen dhe menaxhohen nga vetë specialist i IPSH rastet aktuale të cilat marrin shërbim në IPSH dhe nuk paraqiten në sistemin e SHKSH-së;
- ✚ Mungesa e stafit infermier, kujdestarë në përputhje me standardet.
- ✚ Rritja e kërkesave për sistemim për moshën e tretë dhe sistemim i të moshuarve me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe fizik duke vështirësuar ofrimin e shërbimit.
- ✚ Kriteret për sistemimin e të moshuarve kërkojnë rishikim.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 5 monitorime në qendra zhvillimi (4 rezidenciale dhe 1 ditore) në Berat, Shkodër, Durrës, Lezhë dhe Qendra e Zhvillimit Pëllumbat.

Problematikat e nxjerra janë:

- ✚ Ndërhyrje në infrastrukturë (Shkodër, Berat, Lezhë, Qendra e Zhvillimit “Pëllumbat”).
- ✚ Rishikimi i KMCAP nga mjeku i institucionit për çdo përfitues.
- ✚ Nga monitorimet është konstatuar se ka përfitues mbi moshën 21 vjec si Shkodër, Korçë dhe Berat , gjë që sjell humbjen e funksionalitetit të tipologjisë së shërbimit.

✓ Monitorime të shërbimeve të financuara nga mekanizmi i fondit social

Në përmbushje të përgjegjësisë të përcaktuar në Ligjin Nr.121/2016, datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.159, datë 20.3.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH, realizoi vlerësimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në 46 qendra/projekte të përkujdesit shoqëror, të cilat janë mbështetur me Fond Social për vitin 2023.

Vlerësimi u realizua në:

33 qendra/shërbime publike, ku ofrues dhe administrues është Bashkia;
4 qendra/shërbime publike ku ofrues dhe administrues është institucioni i Këshillit të Qarkut;
9 Qendra/shërbime jopublike të ofruara nga organizata bazuar në marrëveshje me institucionin e Këshillit të Qarkut.

Për nga tipologjia e shërbimit, 46 Qendrat/shërbimet e vlerësuara klasifikohen si më poshtë:

7 shërbime të përkujdesit rezidencial;
4 shërbime të strehimit emergjent;

13 shërbime të përkujdesit në banesë;
2 linja kombëtare telefonike falas për denoncim, këshillimit dhe referim;
20 Shërbime ditore;

Problematikat e hasura:

- ✓ Nga monitorimet të kryera mbi shërbimet sociale të financuara nga mekanizmi i Fondit Social u konstatua se shërbimet e ngritura nga bashkitë nuk janë të pajisura me licencë për ofrimin e shërbimit por operojnë me Niptin e Bashkisë.
- ✓ Nga monitorimet u konstatua se shërbimet rezidenciale ofrohen në përputhje me standardet e miratuara. Ndërkohë u konstatua që disa shërbime komunitare/ditore nuk zbatojnë standardet e përkujdesit shoqëror për tipologjinë përkatëse pasi kanë nevojë për trajnime.
- ✓ Përgjithësisht, shërbimet e mbështetura me Fond Social prej 3 vitesh, rezultojnë shërbime të konsoliduara, funksionale dhe me standarde të plotësuar.
- ✓ Vlerësohet fakti se nuk rezultoi asnjë Qendër/shërbim i konstatuar i pa ngritur apo i mbyllur. Kjo tregon se bashkitë vazhdojnë të kenë një qendrushmëri të shërbimeve të ngritura.
- ✓ Një pjesë e stafeve kanë mbivendosje rolesh duke ofruar shërbime si për qendrat e ngritura ashtu edhe për shërbimet e bashkisë në rolin e NJVNR, PMF, kordinator dhune apo specialistët të fushave përkatëse.
- ✓ Gjithashtu disa prej shërbimeve të ngritura nga Fondi Social nuk popullojnë Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore pasi një pjesë e stafeve duke pasur mbivendosje nuk kuptojnë rolin e tyre ashtu sic është përcaktuar në SHKSH.
- ✓ Nga monitorimi u konstatua se shumë shërbime të ngritura nga bashkitë nuk kanë kriteret të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe kriteret të përcaktuara sipas VKM 518/2018 “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.
- ✓ Stafet e shërbimeve sociale kanë nevojë për trajnime mbi standardet për tipologjitë e shërbimeve që ofrojnë.

Dinamika e IPSH-ve

➤ Institucionet për të moshuar


Gjatë vitit 2024 është vënë re se ka një shtim të numrit të të moshuarve të cilët kërkojnë sistemim në institucionet rezidenciale për të moshuar. Konkretisht, pranë Shërbimit Social Shtetëror janë paraqitur 111 kërkesa për sistemim në institucionet e përkujdesit për të moshuar. Gjithashtu, në këtë shtim të kërkesave për sistemim kemi një rritje të theksuar të të moshuarve të cilët kanë probleme të rënda shëndetësore (mendore dhe fizike) ose edhe janë me PAK, duke sjellë në këtë mënyrë një rritje të numrit të të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore në IPSH-të rezidenciale. Kapaciteti në institucionet rezidenciale publike për të moshuar është **332**, numri aktual i përfituesve që marrin shërbim është **332**. Ndër to, **178** përfitues kanë probleme të shëndetit mendor ose paraqesin nevoja sanitare të shkallës së mesme dhe të lartë. Problemi që sot po hasin institucionet rezidenciale për të moshuar janë të moshuarit që kanë probleme të shëndetit mendor (si; skizofreni, çrregullime psikotike, çrregullime humori, çrregullime të sjelljes, çrregullime personaliteti, demencë senile, alzheimer, prapambetje

mendore etj) pavarësisht diagnozave dhe ashpërsisë së simptomave, shërbimi shëndetësor ofrohet në institucion nga një mjek me kohë të pjesëshme dhe kujdestaret e turnit. Problematika i është përcjellë MSHMS-së ku dhe rishikimi i VKM-së 518/2018.

Kapacitetet e dy institucioneve ditore për të moshuar janë 85 dhe aktualisht numri i përfutuesve është 78. Koncretisht, 50 të moshuar marrin shërbim në Qendrën Ditore Polivalente Sarandë dhe 28 marrin shërbim në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz.

- Kërkesat e të moshuarve për sistemim dhe sistemimet gjatë vitit 2024 të ndara në muaj janë:

Muaji	Numri i kërkesave për sistemim në institucionet rezidenciale për të moshuar	Numri i të moshuarve të komisionuar nga Shërbimi Social Shtetëror
Janar	7	4
Shkurt	4	
Mars	9	5
Prill	16	9
Maj	13	10
Qershor	6	3
Korrik	6	9
Gusht	3	3
Shtator	21	11
Tetor	10	5
Nëntor	14	-
Dhjetor	2	13
Total	111	72



Dinamikat e vitit 2024 në gjashtë institucionet rezidenciale për të moshuar është si më poshtë:

Institucioni	Kapaciteti	Numri i përfituesve	Komisionimet nga bashkia për vitin 2024	Kthimet në familje/largimet
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	50	49		1
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	65	64	21	2
Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	62	62	3	3
Shtëpia e të Moshuarve Fier	55	53	9	1
Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	60	60	10	3
Qendra Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror Poliçan	40	44	2	-
Total	332	332	45	10

Kërkesat për shtetësim në institucionet rezidenciale për vitin 2024 kanë qenë 111. Ndërkohë, viti 2024 ka nisur me 9 (nëntë) kërkesa të mbartura nga vitit 2023. Gjatë vitit 2024 Komisioni Qendror për Vlerësimin e Nevojave të Personave të Moshuar ka sistemuar 72 të moshuar në Institucionet Rezidenciale për të moshuar.

➤ ***Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje:***

Në Qendrën Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2024 janë trajtuar 51 banorë nga të cilët 18 gra dhe 33 fëmijë (14 femra dhe 19 meshkuj), nga të cilët 1 banore ka qenë e mitur e pashoqëruar dhe 1 banore ka qenë shtetase Kosovare.

Numri i përfituesve që kanë hyrë gjatë vitit 2024 ka qenë 54 banorë nga të cilët 19 gra dhe 35 fëmijë (15 femra dhe 20 meshkuj).

Ndërkohë, numri i përfituesve që kanë dalë gjatë vitit 2024 ka qenë 44 banorë nga të cilët 17 gra dhe 26 fëmijë (12 femra dhe 14 meshkuj) dhe 1 banore ka qenë e mitur e pashoqëruar.

➤ ***Institucionet Rezidenciale të Përkujdesit për Fëmijë***

Në 9 institucionet rezidenciale publike janë trajtuar gjatë vitit **172 fëmijë** (105 Meshkuj dhe 67 femra) ku 95 fëmijë kanë marrë kujdestari ligjore të IPSH-ve, me vendim Gjykate.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2024 janë pranuar 61 fëmijë, ku rezulton një rritje e numrit të pranimeve krahasur me vitin 2022 dhe 2023. Nga këto **33 fëmijë janë pranuar në qendrat rezidenciale publike**, dhe **3 fëmijë në qendra jopublike për fëmijë**, me koordinim të PMF dhe SHSSH, të vlerësuara si rast emergjente nga GTN (Grupet Teknike Ndërsektoriale). Janë ndjekur procedurat sipas protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve deri vendosje në kujdestari ligjore me vendim gjykate. Dinamika e fëmijëve në 9 IPSH-të rezidenciale të fëmijëve gjatë

vitit është:

Janë integruar **në jetesë të pavarur 4 të rinj** nga Shtëpia Rinore Shkodër duke u punësuar në biznese të ndryshme.


Janë birësuar gjithsej 15 fëmijë dhe janë në proces **13 fëmijë**, ndërkohë që numri i rikthimeve në familje biologjike **9 fëmijë të rikthyer në familje** është ulur krahasuar me vitet më parë për shkak të vendosjes së fëmijëve me masë mbrojtje me vendim gjykate (marrja e kujdestarisë nga institucioni), duke vështirësuar daljen për shkak të zgjatjes dhe afateve të vendimeve gjyqësore, si dhe vështirësitë për fuqizimin e familjeve biologjike për arsye të ndryshme sociale - ekonomike.

Numri i pranimeve të fëmijëve në institucione rezidenciale është në rritje dhe numri i daljeve krysisht të rikthimeve në familje është në ulje.

Fëmijë të braktisur që në lindje janë 18 dhe pa interesim nga të afërmit janë **12 fëmijë**, ndërsa fëmijë të tjerë të vlerësuar pa interesim sipas **afateve kohore 6 muaj** janë **31 fëmijë**.

Tab. Nr. 3 Dinamikat e Fëmijëve, në IPSH-të rezidenciale publike për fëmijë

Nr	Institucioni	Kapa citeti	Nr femije 2024	Pranime	Të birësuar	Kthim në familjen biologjike
1	Shtëpia e fëmijës 0 - 5 vjeç "Hana & Rozafa", Tiranë	50	34	16	8	2
2	Shtëpia e fëmijës 0 - 5 vjeç Korçë	20	3	0	0	0
3	Shtëpia e fëmijës 0 - 5 vjeç Vlorë	30	0	0	0	0
4	Shtëpia e fëmijës 0 - 5 vjeç Durrës	20 +20 ditor	21 R +15 ditor	8	5	1
5	Shtëpia e fëmijës 0 - 5 vjeç Shkodër	35	19 R+ 8 ditor	12	2	0
6	Shtëpia e fëmijës 6 -15 vjeç Shkodër	70	24	9	0	3
7	Shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli" 6-15 vjec, Tiranë	48	36	6	0	3
8	Shtëpia e fëmijës 6 - 15 vjeç Sarandë	40	24	5	0	0
9	Shtëpia e fëmijës 16- 18 vjeç Shkodër	20	11	5	0	0 dhe 4 integrim ne jete te pavarur
	TOTALI		172	61	15	9 + 4 integrim ne jete te pavarur



➤ ***Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës***

Në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, aktualisht marrin shërbim **36 familje (35 gra, 36 burra dhe 86 fëmijë, 157 individë)**. Pjesa më e madhe e familjeve të strehuara i përket komunitetit rom. Për vitin janar - dhjetor 2024 kanë dalë nga qendra **2 familje**.

➤ ***Statusi i Jetimit***

Lidhur me statusin e jetimit e kanë përfituar statusin 255 persona nga të cilët 26 persona nuk i kanë të dy prindërit, 228 persona janë të lindur jashtë martese dhe 1 personi i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykatë. Gjithashtu janë rinovuar rreth 500 statuse jetimi.

Ka nisur funksionimi on-line i aplikimeve të statusit të jetimit në sistemin elektronik AMS dhe SQDNE, Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik. Gjithsej kanë aplikuar për këtë shërbim **60 raste**.

➤ ***Qendrat e Zhvillimit për PAK***

Aktualisht në 6 qendrat e zhvillimit për PAK marrin shërbim 207 përfitues, nga këto 132 persona mbi moshën 21 vjeç, kjo për arsye si: braktisja e personave që në lindje, probleme social-ekonomike shumë të theksuara në familje, prindërit janë shumë të moshuar si dhe me probleme shëndetësore fizike, mendore dhe e kanë të pamundur të kujdesen për fëmijët.

Gjatë vitit 2024 në 6 qendra të zhvillimit janë sistemuar 9 raste.

Qendrat e Zhvillimit në Korçë, Shkodër dhe Berat kanë humbur funksionalitetin e tyre, për këtë tipologji shërbimi, pasi përfituesit janë mbi moshën 21 vjeç dhe nuk mund të marrin asnjë zhvillim për aftësimin jetësor për shkak të diagnozës. Shërbimet që ofrohen në këto qendra janë të


përqëndruara më shumë në shërbime jetësore si: ushqim, shërbim shëndetësor dhe aktivitete kulturore.

Në këtë kontekst, propozohet ndryshimi i tipologjisë së shërbimit në këto institucione, kjo dhe për shkak të rritjes së numrit të kërkesave, pranë SHSSH-së, për sistemim të personave me aftësi të kufizuar mbi 21 vjeç, të cilët janë të braktisur nga familja apo kanë arsye social-

ekonomike.

Tab. Nr. 1 Dinamikat e PAK në IPSH-të rezidenciale publike

Nr.	Institucioni	Hyrjet	Nr aktual
1	Qendra e Zhvillimit PAK Pllumbat, Tiranë	3	23
2	Qendra e Zhvillimit PAK Durrës	3	39
3	Qendra e Zhvillimit PAK Vlorë	0	33
4	Qendra e Zhvillimit PAK Korçë	1	38
5	Qendra e Zhvillimit PAK Shkodër	1	44
6	Qendra e Zhvillimit PAK Berat	1	30
	Total	9	207



➤ **Qendra Kombëtare Pritëse për Trafikimin**

QKPVT është institucion kombëtar i sigurisë së lartë, që ofron shërbimin për strehim, rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të trafikimit, vendase dhe të huaja.

Gjatë vitit 2024 në qendër janë asistuar **31 përfituese, nga këto 15 femra dhe 16 meshkuj dhe 6 raste të mbartura nga viti 2023**. Prej të cilave 5 raste janë riintegruar jashtë institucionit. 14 viktima kanë qenë me kombësi shqiptare dhe 17 viktima trafikimi me kombësi të huaj.

Të gjitha rastet e trajtuara në qendër janë referuar për shërbime ndihmëse si shëndetësore, juridike, psikologjike, QKPVT ka ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme bazuar në marrëveshje dhe kontrata bashkëpunimi me institucione shtetërore apo private, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë ofruar kontributin e tyre për dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit. Të gjitha rastet e akomoduar pranë QKPVT-së kanë ndjekur sistemin arsimor dhe kualifikimet profesionale për viktimat e trafikimit kanë qenë pjesë e objektivave dhe për këtë vit.

OBJEKTIVI III

PËRMIRËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E RREGJISTRIT ELKTRONIK TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Regjistrit Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, si pjesë e sistemit të integruar të informacionit, mundëson regjistrimin dhe administrimin e të dhënave në nivel Bashkie, Qarku dhe në rang kombëtar për kërkuarit dhe përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për çdo tipologji shërbimi, që nga referimi i rastit deri në mbylljen e tij.

Sistemi ka sjellë:

- ❖ Menaxhimin e disa proceseve dhe vlerësimeve të rasteve të cilat kanë nevojë për përkujdes shoqëror, akomodimin e tyre në institucione rezidenciale dhe ditore për të gjitha tipologjitë e shërbimeve.
- ❖ Aktualisht në sistem funksionon i gjithë workflow me gjithë rolet përkatëse.
- ❖ Duke u bazuar në raportin e gjeneruar nga sistemi numri total i rasteve të hedhura në sistem për periudhën Janar - Dhjetor 2024 është **1577** raste nga këto **159** kanë përshkruar të gjithë workflow-n e sistemit (status: në Trajtim).

Arritje:

- Për vitin 2024, 61 Bashkitë e njohin sistemin e SHKSH-së për të cilat është hapur user aktiv.
- Institucionet e Përkujdesit Shoqëror kanë user-a aktiv dhe kanë filluar popullimin e sistemit.
- Përmirësimi i workflow të sistemit për disa nga kërkesat nga ana e Shërbimit Social në lidhje me të gjitha hapat e ndjekura për menaxhimin e rastit ndërmjet sistemit të SHKSH-së.
- Ndërmjet monitorimit të programit të Fondit Social disa bashki janë nxitur për përdorimin e sistemit dhe kjo ka sjellë një rritje e ndërgjegjësimit të përdoruesve.
- Sistemi ka arritur të ketë 2204 përdorues (usera) nga të cilët për vitin 2024 janë trajnuar 250 përdorues.

Problematikat e ndeshura gjatë përdorimit të SHKSH:

- 🚦 Në disa Bashki vazhdon mungesa e pajisjeve për ta aksesuar, programet kompjuterike shumë të vjetëruara (windows 7) bëjnë që sistemi SHKSH të mos funksionojë dhe mungesa e skanerave që përdoren për të ngarkuar dokumentacionin në sistem.

- ✚ Nuk raportojnë ndërrimet e punonjësve, duke penguar krijimin e përdoruesve të rinj dhe deaktivizimin e atyre të vjetër në sistem.
- ✚ Nga monitorimi i sistemit rezulton që përdoruesit (user) e sistemit dhe pse marrin në vazhdimësi on job training, online dhe të organizuara sipas programit, vazhdojnë të mos e përfundojnë të gjithë workflow-n e sistemit.
- ✚ Vonesa dhe vështirësi në trajtimin e rasteve për shkak të numrit të përdoruesve të dedikuar dhe mungesës së kualifikimit të stafit.
- ✚ Mungesa e ndërgjegjësimit të përdoruesve të sistemit në lidhje me menaxhimin e rasteve nëpërmjet SHKSH-së.
- ✚ Sistemet e ndryshme nuk bashkëpunojnë, duke penguar ndarjen dhe koordinimin e informacionit.
- ✚ Përdoruesit shpesh nuk ndjekin hapat e duhura, duke shkaktuar vonesa dhe mungesë raportimi të problemeve.

❖ **Shkresat e hartuara për KLSH, Avokatin e Popullit:**

- ✓ Mbi AP mbi moshimin nga KLSH është raportuar dy herë lidhur me realizimin e rekomandimeve;
- ✓ Pjesëmarrje dhe raportim në Nënkomisionin Parlamentar “Për auditimin e sektorit publik”;
- ✓ Gjatë vitit 2024 janë hartuar 18 shkresa drejtuar Avokatit të Popullit;
- ✓ Janë hartuar shkresa drejtuar MSHMS për t’i informuar lidhur me problematikat e moshimit dhe propozim për ngritjen e shërbimit të ri për të moshuarit me probleme të shëndetit mendor dhe propozim për rishikimin e VKM 518/2018;
- ✓ Lidhur me AP mbi dhunën në familje nga KLSH është raportuar dy herë lidhur me realizimin e rekomandimeve dhe njëkohësisht është përgatitur informacion dhe përcjellë MSHMS-së mbi mjaftueshmërinë e kapaciteteve akomoduese, si dhe gjendjen e infrastrukturës në QKTVDHF, si dhe informacioni mbi vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapaciteteve akomoduese shtetërore në vend dhe gjendjes së infrastrukturës ekzistuese të shërbimeve sociale për gratë e dhunuara, dërguar dhe MSHMS.

SFIDA

Shërbimi Social Shtetëror në planin e veprimit për vitin 2025 do të ketë sfida zbatimin e objektivave si:

1. Trajnimin e stafeve të institucioneve rezidenciale për të moshuar lidhur me zbatimin e standardeve të reja për të moshuarit, dalë me Udhëzimin nr.168 prot, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”, si dhe stafeve të institucioneve për fëmijë mbi Standardet për Fëmijë 0-5 vjeç.
2. Avancimin e procesit të deinstitutionalizimit.
3. Funksionimi i plotë i SHKSH-së në të gjitha bashkitë e vendit.

III. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PAK

Objekti kryesor është respektimi i legjislacionit dhe kriterëve mjekësorë gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të personave me aftësi të kufizuara si dhe marrja e shërbimit në kohë e pa vonesa. Aktiviteti i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve sipas modelit Bio-Psiko-Social dhe ecuria e KMCAP-et e Nivelit të Parë dhe Epror për komisionimin e personave të cilët kërkojnë përfitimin e statuseve të para- tetrapegjisë dhe verbërisë.

Baza ligjore mbi të cilën bazohet puna e drejtorisë së komisionimit të PAK është: [Ligji Nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”](#); [Ligji Nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”](#); [Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”](#); Vendim nr.277 datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”; Vendim nr. 182, datë 26.2.2020 për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal i ndryshuar me vendimin nr. 189, datë 27.03.2024; Vendim nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë” i ndryshuar me vendimin nr.744, datë 4.12.2024; Vendim nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

Të dhënat për përfituesit nga skemat e aftësisë së kufizuar janë si më poshtë

Viti	PAK	Kujdestarë	PTP	Kujdestarë	Të Verbër	Kujdestarë
2024	54056	9276	5712	5652	13791	3645

1. Skema e vlerësimit biopsikosocial

Janar-Dhjetor 2024	Komisionim Total	Refuzuar	Përfitues	Nivelet e përfitimit				Kujdestar	
				I lehtë	I moderuar	I rëndë	I thellë/I plotë	Niveli 3	Niveli 4
Berat	2516	81	2247	669	1223	355		293	3
Dibër	2799	86	2415	425	1444	546		268	43
Durrës	4085	176	3776	742	1777	1251	6	480	12
Elbasan	7381	119	5311	1469	3180	657	5	342	189
Fier	6074	343	5501	1871	2830	796	4	657	36
Gjirokastrë	1310	124	1176	281	559	336		207	11
Korçë	4443	456	3879	1972	1483	423	1	287	4
Kukës	2061	74	1775	40	1464	270	1	246	24
Lezhe	2408	82	2139	442	1346	351		230	25

Shkodër	2805	163	2368	600	1293	468	7	268	21
Tiranë	8069	396	7037	2332	2570	2114	21	925	275
Vlorë	2182	80	1843	556	933	353	1	237	7
Total	41647	2180	39467	11399	20102	7920	46	4440	650

Të dhënat mbi numrin e personave të komisionuar me vlerësimin biopsikosocial

Nga komisionet e shqyrtimit të ankesave janë rivlerësuar 3853 individë të cilët kanë ankimuar vendimet e komisioneve në qarqe.

Duke qenë se vlerësimin e ri tashmë qytetari orientohet dhe drejt shërbimeve të ndryshme (fizioterapi, logopedi, këshillim/psikoterapi, mundësi punësimi/kurse profesional etj.), pra nuk kufizohet vetëm në pagesën monetare që merrte me skemën e vjetër, komisionet bio-psiko-sociale kanë rekomanduar marrjen e shërbimeve të ndryshme sociale, të punësimit/formimit profesional dhe arsimit sipas tabelës më poshtë për periudhën Janar – Dhjetor.

Qarku	Referuar Shërbime Sociale	Referuar Arsim	Referuar Punësim
Berat	1215	110	130
Dibër	308	41	50
Durrës	1822		41
Elbasan	1353	422	787
Fier	752	45	277
Gjirokastrë	480	30	79
Korçë	3023	603	677
Kukës	1248	58	67
Lezhë	801	59	215
Shkodër	389		381
Tiranë	754	208	170
Vlorë	1894	9	155
Total	14039	1585	3029

1.1 Turi “PAK më afër”

Duke qenë se vlerësimi biopsikosocial është një reformë relativisht e re gjatë muajve mars – prill në të 12 qarqet e vendit u kryen takimet për parë ecurinë e kësaj reforme. Në të gjitha takimet rajonale përveç komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, pjesëmarrës ishin përfaqësues të shërbimeve sociale në bashki së bashku me administratorët shoqërorë të njësive vendore, Operatori i Kujdesit Shëndetësor/NJVKSH së bashku me mjekë familje/specialistë, AKPA, Zyra Arsimore, qendrat ditore/rezidenciale (publike dhe jopublike) të cilët kanë në fokusin e tyre ofrimin e shërbimeve për personat me aftësitë kufizuar si dhe persona me aftësi të kufizuar të cilët janë përfitues të pagesës dhe shërbimeve të ndryshme. Gjatë takimeve u diskutuan dhe u ndanë problematikat e hasura deri më tani si nga komisionet e vlerësimit ashtu dhe nga aktorët e tjerë pjesë e zinxhirit të vlerësimit dhe ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar, një sesion të veçantë mori etika e komunikimit.

Problematikat e dala nga turi

- Plotësimi i dokumentacionit për vlerësimin biopsikosocial
- Plotësimi i formularëve me diagnoza jashtë kriterëve të udhëzuesit të vlerësimit biopsikosocial nga mjekët specialistë, si dhe dërgimi i formularëve pa ekzaminime/konsulta mjekësore siç e përcakton udhëzuesi i vlerësimit biopsikosocial.

Mjekët nuk i bashkëngjisin ekzaminimet që kërkohen sipas diagnozave përkatëse duke çuar në vonesa në komisionime dhe sorollatje të qytetarëve, shpesh herë mjekët specialist apo të familjes mbajnë ekzaminimet origjinale në dosjet përkatëse dhe nuk ja u japin qytetarëve një kopje të njësuar me vulën e institucionit.

- Mospërfshirja në udhëzuesin e vlerësimit biopsikosocial të diagnozave që kanë qenë në kriteret e vlerësimit të skemës së vjetër (p.sh.: diabet melitus tip 1, epilepsi, prapambetje mendore e lehtë me çrregullim të sjelljes); diagnoza të cilat janë gjenetike (të rralla) nuk janë përfshirë në udhëzues e vlerësimit. Ka diagnoza që janë te kriteret e fëmijëve por jo te të rriturit edhe pse gjendja shëndetësore nuk ndryshon me kalimin e viteve.
 - Nga NJVKSHT Tiranë u ngrit shqetësimi që formularit i mjekut specialist është shumë i ngarkuar dhe duhet parë mundësia për të qenë më i përmbledhur.
 - Në shumë qarqe të vendit u raportua për vështirësi në sistemin e referimit për kryerjen e ekzaminimeve të ndryshme që kërkohen në udhëzues, shpesh nuk ka fasha për kryerjen e këtyre ekzaminimeve në kohë duke humbur afatin e komisionimit dhe për rrjedhojë të drejtën e përfitimit të pagesës.
 - Pamundësia për të kryer vlerësimi/ekzaminime nga terciari çdo vit si dhe mungesa e mjekëve specialistë në disa qarqe sjell vonesa në plotësimin e dokumentacionit pasi qytetarët orientohen në QSUT.
 - Mosplotësimi i formularit të kontrollit vjetor sidomos në rastet e shëndetit mendor, edhe pse u është komunikuar disa herë administratorëve të njoftojnë qytetarët për plotësimin e këtij formulari.
 - Nisur nga numri i lartë i përfituesve të shëndetit mendor një problematikë ngelet mungesa e qendrave komunitare të shëndetit mendor në qarqe, edhe në ato qarqe ku ka psikiatër mungon psikologu dhe punonjësi social për të bërë vlerësimin dhe ndjekjen nga ekipi multidisciplinar.
 - Nga kontrolli i kryer nga grupi i kontrollit të ngritur me urdhër ministri të MSHMS, pranë mjekëve specialistë rezulton se shpeshherë nuk kanë kartela të plotësuar për qytetarët që orientojnë drejt komisioneve biopsikosociale, dhe në formularët e dorëzuar pranë komisionit mungon vula e institucionit. Në sistemin elektronik të aftësisë së kufizuar ka një fushë për historikun shëndetësor por që nuk ka asnjë informacion.
 - Ka raste (sidomos fëmijë me leucemi) që janë përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar por që në momentin e rikomisionimi janë jashtë për arsye kurimi duke humbur të drejtën për tu rikomisionuar dhe për rrjedhojë dhe pagesën e aftësisë së kufizuar.
 - Dokumentacioni nga ISSH shpesh herën nuk është i njëjtë (sistemi jonë me vërtetimet e sjella nga qytetari), në sistem historiku është vetëm për vitin e fundit duke mos patur informacion të plotë për 5 vjeçarin e fundit.
 - Ka raste që kanë qenë përfitues në skemën tonë, kanë ndërprerë përfitimet për një periudhë 1 ose 2 vjeçare për arsye se janë punësuar dhe në momentin që janë larguar nga puna kërkojnë të vlerësohen përsëri nga komisionet tona. Është e paqartë se si duhet të procedohet në këto raste, ne i kemi orientuar drejt ISSH po në momentin që ata nuk janë invalidizuar në kushte pune andej dalin jo përfitues e drejtohen përsëri te ne, kjo çon në sorollatje për qytetarin.
- Shërbimet, hartimi dhe ndjekja e planit individual për përfituesit
- Problematikë ngelet zbatimi i legjislacionit nga ana e administratorëve shoqërorë lidhur me verifikimin 3 mujor në banesë dhe plotësimin e kalendarit të pagesave. Mungon formulari i kontrollit 3 mujor për administratorët shoqërorë si dhe nga ana e tyre u

diskutua që është e pamundur verifikimi çdo 3 muaj i përfituesve për shkak të mungesës së burimeve njerëzore.

- Mos hartimi dhe ndjekja e planit individual nga ana e administratorëve shoqërorë sjell moszbatimin dhe referimin drejt shërbimeve të rekomanduara nga komisioni multidisciplinar.
- Në pjesën më të madhe të bashkive mungojnë shërbimet (logopedi, fizioterapi, këshillim etj) për personat me aftësi të kufizuar
- Individë të vetmuar ose me anëtarë të moshuar në familje të cilët banojnë në zona të thella e kanë gati të pamundur të plotësojnë dokumentacionin në kohë dhe të marrin shërbimet e ndryshme për shkak të largësisë nga qendrat shëndetësore apo shërbimeve të tjera.
- Në lidhje me punësimin e përfituesve të PAK ka numër të madh referimesh pranë zyrave të punës dhe ka raste suksesi, por ndërkohë në pjesën më të madhe të skedave ka pak informacion mbi situatën aktuale të formimit apo mundësisë për punësim. Gjatë takimeve nga ana e zyrës së punës në disa qarqe u ngrit pretendimi se personat nuk janë informuar më parë nga ana e administratorëve shoqërorë apo komisionit për referimin te zyrat e punës.
- Mungesa e qendrave rezidenciale për personat me aftësi të kufizuar mbi 21 vjeç. Ka shumë raste në moshë madhore të cilët janë me diagnozë të shëndetit mendor dhe nuk kanë asnjë të afërm, apo i kanë prindërit në moshë të thyer dhe të pamundur për tu shërbyer.
- Nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar u ngrit problematika e kohës së pamjaftueshme për mësues ndihmës, aktualisht mësuesi ndihmës në shkolla ofrohet vetëm për 2 orë nga ZVA.
- Nga ZVA u ngrit shqetësimi i mungesës së mjekut në komisionet e vlerësimit të tyre për përcaktimin e mësuesve ndihmës.

➤ **Infrastruktura komisioneve**

- Komisionet e shqyrtimit të ankesave janë të ngritura me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të institucioneve në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, nuk janë në strukturën e Drejtorisë së Komisionimit të PAK.
- Në 6 qarqe (Korçë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Kukës dhe Dibër) stafet e komisioneve janë me kohë të pjesshme (6 orarsh), duke patur një ngarkesë e cila mund të ndikojë në cilësinë e ofrimit të shërbimit. Është vështirë gjetja e mjekëve për komisionet e vlerësimit, edhe aty ky vendi i mjekut të komisionit është në strukturë është e pamundur gjetja e mjekëve me kohë të plotë. Deri më tani me kohë të plotë mjekët janë në Tiranë dhe dy komisione në Durrës, në qarqet e tjera (Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Lezhë) ka qenë e mundur gjetja e mjekëve me kohë të plotë dhe janë marrë me kohë të pjesshme pasi janë mjekë familje apo mjekë specialist në rrethet e tyre.
- Infrastruktura në disa komisione nuk është e përshtatshme si për punonjësit ashtu dhe për qytetarët që marrin shërbim.

1.2 Burime njerëzore të kualifikuara në nivel rajonal dhe vendor

- Gjatë muajit shtator duke patyr synim ngritjen e kapaciteteve të stafeve (mjek, punonjës social dhe operator), përmirësimin e performancës së punës dhe kryesisht shkëmbimin

e eksperiencave mes komisioneve, janë kryer trajnime për të gjithë stafet e 37 komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social.

- Gjatë muajve shtator - tetor nga Drejtoria e Komisionimit të PAK u krye monitorimi i komisioneve të vlerësimit në qarqet Dibër, Kukës, Lezhë, Fier dhe Gjirokastrë.
- Në vijim të trajnimeve të realizuara me 37 komisionet e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me mbështetjen e UNICEF, për të forcuar më tej dialogun ndërmjet nivelit lokal, rajonal dhe qendror në procesin e zbatimit të vlerësimit bio - psiko - social dhe forcimin e lidhjeve me mekanizmin vendor të referimit, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistëve në fushën sociale, gjatë muajve nëntor – dhjetor, janë mbajtur 12 takimet e forumeve rajonale ku u diskutua mbi shkëmbimin e praktikave të mira dhe forcimin e dialogut për mekanizmat e referimit (planet sociale lokale, aftësia e kufizuar, NJVNR etj). Pjesëmarrës në forume ishin drejtues të shërbimit social rajonal, përgjegjësit dhe punonjësit socialë të zyrave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, drejtues të shërbimeve sociale të pushtetit lokal, administratorë socialë dhe punonjës socialë.
- Në muajin maj me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, Zyra Rajonale e Punësimit dhe Aftësive, Qendra e Formimit Profesional, Bashkitë, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të kujdesit shëndetësor, Qendra për ofrimin e Ndihmës Ligjore Falas, Ofrues të shërbimeve sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar, Organizata lokale të Personave me Aftësi të Kufizuar, janë kryer takime konsultative në qarqet Vlorë, Shkodër, Korçë dhe Tiranë në kuadrin e hartimit të raportit të monitorimit afatmesëm të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025, me qëllim informimin dhe konsultimin e gjetjeve kryesore të raportit me të gjithë aktorët përfshirës në nivel vendor.

2. KMCAP për vlerësimin e statuseve e para–tetraplegjisë dhe verbërisë

Për vlerësimin e personave që kërkojnë përfitimin e statusit të para-tetraplegjisë dhe të të verbërit janë dy komisione në nivelin e parë dhe dy komisione në nivelin Epror (1 komision për vlerësimin e statusit të para-tetraplegjisë dhe 1 komision për vlerësimin e statusit të të verbërit). Komisionet si në nivelin e parë ashtu dhe në KMCAP Epror kanë në përbërjen e tyre mjek specialist të fushave përkatëse, mjek përfaqësues të SHSSH dhe 1 jurist. Vihet re një numër i madh dosjesh komisionuar për herë të parë për statusin e të verbërit, gjatë 2024 janë komisionuar 1908 raste për herë të parë.

Numri i dosjeve të komisionuara nga KMCAP Niveli i parë dhe Epror për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është si më poshtë:

Nr	KMCAP Niveli I parë	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues	DIV
1	Status para - tetraplegji	2747	2083	167	497
2	Status Verbëri	3695	2377	444	874

Nr	KMCAP EPROR	Komisionuar	Përfitues	Jo përfitues
1	Status para - tetraplegji	638	519	119
2	StatusVerbëri	997	869	128

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për **MISION** zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 30 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve,
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror,
- 61 Njësi Administrative.


Gjatë vitit 2024 nga ana e DFS janë vendosur disa **OBJEKTIVA** të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

OBJEKTIVAT 2024


- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Bonusi i bebes
- Programi i Grave të Papuna
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Bazuar në raportimin periodik statistikorë, më poshtë paraqitet numri i familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2023-2024.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2023-2024 (pa përfshirë individët dhe 6%)




Siç shihet nga grafiku, nga viti 2023 me 2024, kemi rënie të numrit të familjeve përfituese të NE.



*Grafik nr.2:Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve 2023-2024.
Tregues: Fondi për familjet pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2023-2024
(pa përfshirë individët dhe 6%).*

- Për vitin 2023 4,812,149,017 lekë
- Për vitin 2024 4,086,355,710 lekë




Grafik nr.3 : Fondi për familjet pjesë e skemës së NE 2023-2024

Nëse krahasojmë fondin e shpenzuar në 2023 me 2024 referuar familjeve përfituese të NE, shohim që fondi është ulur.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2023-2024 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid pune)


- Për vitin 2023 72.474 persona me AK
- Për vitin 2024 73.559 persona me AK



Grafik nr.4 : Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK


Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2023 15,154,404,106 lekë
- Për vitin 2024 15,449,087,980 lekë



Grafik nr.5 : Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK


Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2024 për secilin qark i krahasuar me vitin 2023.



Grafik nr.6 : Krahاسimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.

Invalidët e punës

- Për vitin 2023 72.484 invalidë pune
- Për vitin 2024 71.973 invalidë pune



Grafik nr.7 : Numri mesatar i invalidëve të punës


Numri i invalidëve të punës ne vitin 2024 është ulur me 511 persona, në krahasim me vitin 2023.

Shënim: Analiza vjetore 2024 për **statistikat zyrtare** paraqitur më lartë, të familjeve në skemën e Ndhmës Ekonomike dhe PAK bazohet në të dhënat vjetore.

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxheti i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:


- 2023 30,600,443,687 lekë
- 2024 30,332,520,996 lekë



Grafik: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2023-2024

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606


- Për vitin 2023 5,987,103,044 lekë ose 96%
- Për vitin 2024 5,763,983,902 lekë ose 98%



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606

- Për vitin 2023 18,349,195,850 lekë ose 98%
- Për vitin 2024 19,612,354,218 lekë ose 99 %




Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2023 676,492,664 lekë ose 99.5%
- 2024 787,063,581 lekë ose 99.7%




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2023-2024

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 99.7%, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2023 112,393,888 lekë ose 98%
- 2024 131,269,842 lekë ose 98.8%




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2023-2024

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 98.8 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2023 331,025,964 lekë ose 99.7%
- 2024 363,942,653 lekë ose 99.5%




Grafik: Akordimi i fondeve për llogarinë 602 për vitet 2023-2024

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 99.5%, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:


- 2023 176,293,132 leke ose 89%
- 2024 275,365,973 leke ose 85%



Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 230 Investime është:

➤ 2024 5,975,061 leke ose 99.9 %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 230 për vitet 2024

F. Realizimi i fondeve të shpenzuara për programin Grate e Papuna është:

➤ 2023 779,824,320 leke ose 97%

➤ 2024 862,709,760 leke ose 99%




Grafik: Akordimi i fondeve Programin Grate e Papuna 2023-2024

Realizimi i fondeve për programin e Grave te Papuna është në masën 99%, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

G. Realizimi i fondeve të shpenzuara për Bonusin e Bebes është:

➤ 2023 23,040 çeqe me fond 3,305,516,000 lekë

➤ 2024 6,565 çeqe me fond 2,200,000,000 lekë




Grafik: Akordimi i fondeve të bonusit të bebes.

Vihet re një rënie e numrit të ceqeve të shpërndara pasi përgjatë vitit 2024 për shkak të ndryshimit të VKM nr. 824 dt 28.12.2023, të ndryshuar. Sipas këtij ndryshimi, për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura, në çdo rast, prindi/prindërit, krahas dokumentacionit të percaktuar paraqesin edhe formularin e vetëdeklarimit prane drejtorise rajonale te gjendjes tuaj civile, i cili dergohet per verifikim prane Drejtorise se Kufirit dhe Migracionit, që verteton se 180 dite kalendarike, shtetasi ka qenë brenda territorit të Republikës së Shqiperisë.

H. Realizimi i fondeve të shpenzuara për Ndërmarrjet Sociale 604 për vitin 2024

- *Plani* 9,333,000 lekë
- *Fakti* 3,676,909 lekë



Grafik: Akordimi i fondeve për ndërmarrjet sociale 2024

Përgjatë vitit 2024, përfitues të fondit për ndërmarrjet sociale kanë qënë 2 ndërmarrje (QSNNN dhe SHKIZH), ndërmarrje të cilat promovojnë rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e mundësive për punësim të grupeve të pafavorizuara. Realizimi i këtij fondi është 40%, realizim i ulët për shkak se ndërmarrjet sociale kanë filluar aktivitetin në muajin Maj 2024.

Ndërkohë disa nga **PROBLEMATIKAT** e hasura përgjatë vitit 2024 janë si më poshtë;

- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë i fondit nga ana e tyre.
- Plotësimi i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë.
- Mungesa e udhëzimit të ri në mbështetje të V.K.M. Nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale, sjell mungesën e informacionit të detajuar për monitorimin e plotë të këtyre tre programeve.
- Që pas ndryshimit të VKM nr 824 dt 28.12.2023 dhe ligjit nr 79/2023, përfitues të bonusit janë vetëm prindi/prindërit që kanë jetuar 180 ditë në Shqipëri. Problematika lidhet me formularin e vetdeklarimit pranë Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit.

PROPOZIM

- Publikimi i udhëzimit të ri në mbështetje të V.K.M. Nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër.
- Unifikimi i formularëve të dërguara për NE,PAK dhe Sherbimet Sociale dërguar në DPSHSSH nga DR.
- Komunikim i vazhdueshëm me drejtorite Rajonale si dhe IPSH mbi fondet e shpenzuara në mënyrë që të evidentohen problematikat dhe të mos ketë djegie të fondeve në fund të vitit.

OBJEKTIVAT e vendosura për vitin 2025 nga DFS janë:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Përgatitja e planit ekonomiko-financiar të insitucionit
- Mirë-menaxhimi i Bonusit i bebes
- Mirë-menaxhimi i Programit te Grave te Papuna
- Mirë-menaxhimi i Projekteve te Ndërmarrjeve Sociale
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Synimi i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme për vitin 2024 ka qenë menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore, zbatimi i legjislacionit, ndjekja e ciklit të projekteve dhe garantimi i transparencës dhe komunikimit me publikun. Aktivitetet e zhvilluara ndahen sipas sektorëve si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Objektivi Specifik 1: Zhvillimi i procedurave të konkurimit për vendet vakante

Gjatë vitit 2024, është realizuar identifikimi i vazhdueshëm i vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme, Drejtoritë Rajonale dhe IPSH. Shpalljet janë përgatitur dhe publikuar rregullisht në faqen zyrtare të SHSSH, aplikimet janë shqyrtuar brenda afateve ligjore dhe procedurat e rekrutimit janë zhvilluar sipas dispozitave në fuqi. Në fund, kontratat janë nënshkruar dhe HRMIS është përditësuar vazhdimisht.

Objektivi Specifik 2: Rritja e kapaciteteve të punonjësve

Është realizuar identifikimi i nevojave për trajnim në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet vartëse. Thirrjet e trajnimeve të dërguara nga ASPA dhe partnerë të tjerë janë shpërndarë në kohë reale pranë stafit, duke mundësuar përfshirjen në trajnime profesionale.

II. SEKTORI JURIDIK

Objektivi Specifik 1: Ndjekja e procedurave të përfaqësimit gjyqësor

Është siguruar përfaqësimi i rregullt i institucionit në të gjitha çështjet ku SHSSH ishte palë. Janë përgatitur dokumentacionet ligjore dhe janë ndjekur afatet ligjore në mbledhjen e provave dhe dërgimin e prapësimeve.

Objektivi Specifik 2: Zhvillimi i Komisioneve për përjashtimin nga taksat doganore

Janë informuar qytetarët mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm. Mbledhjet e komisioneve janë organizuar në kohë dhe janë lëshuar vërtetimet përkatëse pranë degës doganore pa vonesa.

Objektivi Specifik 3: Ndjekja e procesit të njohjes së legjislacionit

Janë monitoruar vazhdimisht botimet e Fletoreve Zyrtare, aktet e reja janë shpërndarë pranë njësive dhe janë publikuar në faqen zyrtare. Të gjitha shkresat e ardhura janë trajtuar dhe kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

Objektiv III: Shqyrtimi i kontratave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ku ka qënë palë SHSSH .

Gjatë vitit 2024 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka shqyrtuar disa kontrata dhe Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

- Kontrata e ruajtjes fizike te institucionit nga Illyrian Guard.
- Kontrata e shërbimit me objekt: “Hartim projekt-preventiv Zbatimi për Rikonstruksionin e Godinës “Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë”.
- Marrëveshje Bashkëpunimi për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit midis SHSSH, Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale Durrës, Nisma “Arsis” dhe Shtëpisë së Fëmijëve Durrës.
- Marrëveshje Bashkëpunimi për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit midis Bashkisë Tiranë, SHSSH, Drejtorisë Rajonale Tiranë, Nisma “Arsis”, Shtëpisë së Fëmijëve Hanna dhe Rozafa dhe Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor “Zyber Hallulli”.

Invetarizimi dhe Regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme në administrim të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror në zbatim të VKM nr.28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, të shkresës nr.1556/1 prot, datë 12.04.2023, protokolluar me tonën nr.5464 prot, datë 23.05.2023 “Për ngritjen e strukturave të posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave”, ka ngritur strukturën e posaçme me Urdhërin nr.276, datë 26.05.2023, “Për ngritjen e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave”.

Ka hartuar listën paraprake të pronave në administrim të SHSSH duke evidentuar dhe problematikat përkatëse si dhe e ka dërguar në MSHMS.

Institucionet e varësisë kanë aplikuar në ASHK për rifreskim të kartelave të pasurise dhe lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, ku një pjesë e institucioneve ka marr përgjigje dhe është pajisur me informacion të rifkreskuar dhe për një pjesë të aplikimeve nuk është marr përgjigje nga ASHK lidhur statusin juridik të pronësise ose përgjigja nuk është e qartë/kërkohen

më shumë të dhëna për pronën. Aktualisht rezultojnë të pajisura me Çertifikatë Pronësie 4 objekte/prona.

Sfidë ngelet regjistrimi i objekteve për të cilat nuk ka pasur regjistrim fillestar të pronës/VKM dhe nuk kemi një përgjigje nga ASHK për statusin juridik të tyre.

Të tjera:

- Sektori Juridik ka qenë pjese e grupeve të punës për hartimin e Rregulloreve të Brendshme për 4 IPSH, në bashkëpunim me sektorët përkatës:
 - Rregullore e Brendshme për Qëndrat e të Moshuarve
 - Rregullore e Brendshme për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor 6-16 vjeç (Zyber Hallulli)
 - Rregullore e Brendshme për Shtëpine e Foshnjës Tiranë.
 - Rregullore e Brendshme për QKTVDHF.
- Sektori Juridik ka marr pjesë në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël të realizuara gjatë vitit 2024 si dhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim projekt-preventiv Zbatimi për Rikonstruksionin e Godinës “Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë”.
- Sektori juridik ka qenë pjese e Task-Forcës së ngritur për verifikimin social ekonomik në banesë të familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Objektivi Specifik 1: Ndjekja e ciklit të projekteve të miratuara

Në kuadër të menaxhimit të projekteve, është firmosur kontrata për projektin "Elderly - Improving the social care system for elderly people in Albania". Implementimi i fazës së parë është finalizuar me sukses, duke identifikuar dhe përditësuar hartat e përfituesve dhe duke hartuar termat e referencës për angazhimin e operatorëve socialë.

Objektivi Specifik 2: Garantimi i transparencës së veprimtarisë

Janë realizuar publikime të rregullta të materialeve informuese, çka ka ndihmuar në rritjen e transparencës së veprimtarisë institucionale. Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve si dhe statistikat e ndihmës ekonomike dhe PAK janë përditësuar sipas afateve të paracaktuara.

Objektivi Specifik 3: Monitorimi i medias dhe garantimi i korrupsionit zero

Është realizuar monitorimi sistematik i mediave të shkruara dhe elektronike. Rastet e identifikuar janë trajtuar me seriozitet dhe është bashkëpunuar ngushtë me gazetarët për garantimin e informimit të saktë publik.

Objektivi Specifik 4: Komunikimi me publikun dhe adresimi i problematikave

Të gjitha ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve të ardhura nga kanale të ndryshme janë trajtuar me përparësi. Bashkëpunimi me strukturat përkatëse ka bërë të mundur zgjidhjen e problematikave në mënyrë të shpejtë dhe efektive.

Objektiv I: Ndjekja e ciklit të projekteve dhe organizimi i aktiviteteve

Gjatë vitit 2024 Sektori I Projekteve në bashkëpunim me ASET, Regione Liguria dhe Regione Marche në Itali kanë finalizuar aplikimin për projektin e titulluar “Eldearly – Improving the Elderly Care System in Albania”. Projekti u hartua në kuadër të thirrjes së dytë për projekt-propozime nga IADSA. Projekt-propozimi i Shërbimit Social Shtetëror u mbështet nga IADSA dhe zyrtarisht ka nisur zbatimin në vitin 2024. Zbatimi do të zgjasë 24 muaj. Ky projekt do të sjellë një risi në kujdesin për të moshuarit në Shqipëri pasi përpos ofrimit të shërbimeve publike rezidenciale dhe ditore, edhe ngritja e dy linjave të këshillimit për të moshuarit.

Po ashtu, gjatë vitit 2024 janë organizuar dhe koordinuar një sërë aktiviteteve në kuadër të ditëve të shënuara ose jo. Konkretisht:

- 1 Qershor - Aktivitet argëtues në kuadër të festës së fëmijëve pranë Shtëpisë së Hannah dhe Rozafës;
- Trajnim mbarë-kombëtar për Modelin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social me stafet e 37 KVSHAK në të gjithë Shqipërinë;
- 1 Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër;
- 19 Tetor - Fushatë ndërgjegjësimi kundër trafikimit në kuadër të muajit kundër trafikimit në persona;
- 24 Nëntor - Aktivitet prezantues me natyrë artistike dhe sportive në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”
- 30 Nëntor - Aktivitet ndërgjegjësimi në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës;
- 3 Dhjetor - Aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për PAK në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës;
- 28 Dhjetor - Aktivitet festiv në Shtëpinë e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” në kuadër të festave të fundvitit.

Objektiv II: Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2024 mbështetur me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror përmes përditësimit të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale. Konkretisht:

1. Janë publikuar 10 Buletine Informative dhe 14 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;
2. Është bërë përditësim i Regjistrat të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj;

3. Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
4. Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH ka kthyer 15 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afati i kthimit të përgjigjes prej 14 ditësh. Numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

Objektiv IV: Marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2024 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore. Konkrektisht:

Portali i Bashkëqeverisjes	Rrjete sociale
720	255

Pjesa më e madhe e rasteve të ardhura në portal kanë qenë në fushën e aftësisë së kufizuar, ku kanë qenë të përqendruara në:

1. Ndryshimin e pagesave të personave të aftësisë së kufizuar me reformën e re ka sjellë një numër të lartë të ankesave pranë KSHA.
2. Mospërfshirja e disa diagnozave në udhëzues që më parë kanë qenë përfitues.
3. Mund të ketë pasur vonesa të përgjigjeve ku në të shumtën e rasteve kanë qenë si pasojë e mosdhënies së të gjitha të dhënave nga qytetarët që e ka zgjatur procesin e verifikimit.

Objektiv V: Monitorimi i medias

Gjatë vitit 2024 janë identifikuar dhe trajtuar 65 raste mediatike. Pjesa më e madhe e rasteve janë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe potencialisht kjo rritje mund të ketë ardhur nga ndryshimi i skemës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.